

PROGRAMI BUXHETOR
AFATMESEM
2019-2021



Tirana

		Faqe
	Hyrje	2
KAPITULLI I	Procesi i Programit Buxhetor Afatmesëm dhe Roli i tij	3
KAPITULLI II	Prioritetet Afatmesme 2019 – 2021	8
KAPITULLI III	Parashikimet Buxhetore Afatmesme 2019 – 2021	13
III.1	Të Ardhurat e Bashkisë së Tiranës për Periudhën 2019 – 2021	13
III.2	Transfertat nga Buxheti i Shtetit	29
III.3	Burime të tjera financimi / Donacione	32
III.4	Parashikimi i shpenzimeve për Periudhën 2019 - 2021	35

HYRJE

Hartimi i Programit Buxhetor Afatmesëm (PBA), mbështetet në ligjin nr. 9936, datë 26.06.2008 për "Menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"(i ndryshuar), Ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", ligjit nr. 68/2017 "Për financat e vetëqeverisjes vendore" dhe në Udhëzimet e Ministrisë së Financave për përgatitjen e buxhetit vendor.

Programi Buxhetor Afatmesëm i Bashkisë së Tiranës është hartuar në bazë të programeve të zhvillimit të qytetit, bazuar në funksionet e pushtetit vendor të përcaktuara në ligjin nr.139, datë 17.12.2015, "Për vetëqeverisjen vendore", në strukturat buxhetore të programeve që parashikojnë aktet ligjore mbi buxhetin si edhe në funksionet që ushtron aktualisht Bashkia e Tiranës. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program buxhetor. Objektivat e çdo programi janë përcaktuar nga Njësitë Shpenzuese të përfshira, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse.

Baza mbi të cilën janë përcaktuar sektorët parësorë të zhvillimit dhe identifikimit të prioritetëve të shpërndarjes së burimeve për periudhën 2019-2021 janë kërkesat e qytetarëve, të shprehura përmes diskutimeve publike me qytetarët e të 27 njësive administrative dhe programi qeverisës i Kryetarit të Bashkisë për vitet 2015-2019, i reflektuar në Strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qendrueshëm të Bashkisë Tiranë.

Projekt-buxhetet bazohen në vizionin tonë për Tiranën e së ardhmes, e cila para së gjithash duhet të jetë një qytet i jetueshëm, me infrastrukturë moderne e transport publik cilësor, me shërbime efikase e cilësore, me mundësi investimi për sipërmarrësit, me një jetë kulturore të larmishme e me hapësira të dedikuara për fëmijët, të moshuarit, këmbësorët e çiklistët. Ne besojmë se pavarësisht problemeve të shumta, Tirana fsheh një potencial të jashtëzakonshëm ekonomik, social e kulturor.

KAPITULLI I PROCESI I PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM DHE ROLI I TIJ

Hartimi i PBA-së përbën një proces shumë të rëndësishëm për Bashkinë e Tiranës, pasi ky dokument siguron mekanizmat e nevojshme përmes të cilave, objektivat prioritarë të identifikuar në Strategjinë e Bashkisë së Tiranës, të integrohen sa më mirë në procesin buxhetor. Rol domethënës në hartimin e kësaj PBA-je kanë luajtur edhe qytetarët e Tiranës, të cilët në kuadër të takimeve “Buxhetimi me pjesëmarrje” kanë shprehur prioritetet e tyre për shpenzimet publike.

Objektivat e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- a. Përmirësimi i menaxhimit dhe rritja e efikasitetit të përdorimit të fondeve publike, është objektivi parësor i PBA-së, në funksion të të cilit, angazhimi dhe mbështetja serioze e me përgjegjësi të lartë e të gjitha njësive pjesëmarrëse në PBA, mbetet thelbësore për ecurinë e suksesshme të këtij procesi.
- b. Sigurimi i një shpërndarjeje të drejtë efiçente të burimeve është objektivi nëpërmjet të cilit synohet të arrihet:
 - Një kuadër i qëndrueshëm planifikimi afatmesëm, brenda të cilit të planifikohen buxhetet vjetore,
 - Lidhje e drejtpërdrejtë mes programeve politike të Bashkisë dhe alokimit të burimeve.

Qëllimet e Programit Buxhetor Afatmesëm:

- Sigurimi i një buxheti të qëndrueshëm, mbështetur në objektiva dhe prioritete afatmesme (tre vjeçare), brenda një kuadri realist makroekonomik dhe fiskal;
- Inkurajimi i efektivitetit, efikasitetit dhe ekonomisë në kryerjen e shpenzimeve publike dhe alokimit të burimeve;
- Forcimi i disiplinës fiskale.

Roli i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Programi Buxhetor Afatmesëm është instrumenti më i rëndësishëm i menaxhimit financiar, i cili synon integrimin e programit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2015-2019 me nevojat e qytetarëve duke i përkthyer në politika vendore dhe konkretizuar në plane shpenzimesh.

Ky dokument synon të informojë Këshillin Bashkiak të Tiranës dhe publikun e gjerë lidhur me planet afatmesme të shpenzimeve të Bashkisë, të cilat do të çojnë në arritjen e objektivave strategjike të programit të Kryetarit të Bashkisë së Tiranës.

Dokumenti synon t'i japë mundësinë Këshillit Bashkiak, si organ vendimmarrës, për të zhvilluar një kuadër të qartë burimesh në periudhë afatmesme që do të shërbejë si bazë për planifikimin vjetor të shpenzimeve korrente dhe kapitale të Bashkisë.

Ky program iu shërben gjithashtu Njësive Shpenzuese pasi mundëson përcaktimin në mënyrë të qartë prej tyre të politikave dhe programeve për çdo aktivitet, për të përcaktuar kostot dhe prioritetet e tyre brenda kontekstit të burimeve të disponueshme, në mënyrë që burimet financiare të mund të alokohen tek programet prioritarë në periudhën afatmesme.

Ky proces synon parashikimin e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale, si një mjet që përkthen qëllimet dhe objektivat strategjike në synime financiare, duke prezantuar politikatat fiskale dhe financiare të Bashkisë së Tiranës.

Struktura e përgjithshme e Programit Buxhetor Afatmesëm:

PBA-ja është hartuar në bazë të programeve, ku çdo program lidhet me një funksion të veçantë të pushtetit vendor, brenda të cilit janë përfshirë një ose më shumë Njësi Shpenzuese, në përputhje me funksionet dhe qëllimet përkatëse. Dokumenti i PBA-së, prezanton me detaje qëllimet, objektivat dhe produktet për çdo program. PBA-ja është hartuar për të gjitha programet e Bashkisë dhe është fokusuar në programet prioritare, të cilat janë shprehje e kërkesave dhe nevojave të komunitetit duke u ndërrhur me programin politik të Kryetarit të Bashkisë.

Për çdo program janë parashikuar të gjitha shpenzimet që do të shërbejnë për realizimin e objektivave të tij, sipas llojit dhe Njësive Shpenzuese.

Shpenzimet:

- a. Shpenzimet korrente (paga, sigurime, shpenzimet operative dhe të mirëmbajtjes, interesa),
- b. Shpenzimet kapitale.

Njësitë Shpenzuese:

- a. Aparati i Administratës së Bashkisë së Tiranës
- b. Institucionet e varësisë

Konsultimi i Programit Buxhetor Afatmesëm:

Në mbylljen e vitit kalendarik 2018, i cili shënon një tjetër arritje historike për Bashkinë e Tiranës, në aspektin e performancës financiare dhe shtrirjes së investime publike në çdo cep të Tiranës, janë realizuar sërish dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin 2019-2021.

Bashkia e Tiranës i jep përparësi thelbësore përfshirjes qytetare si hallkë e rëndësishme në vendimmarrje, për sa i përket projekteve, investimeve dhe shërbimeve që ky institucion garanton ndaj qytetarëve të kryeqytetit. Vendimmarrjen me pjesëmarrje Bashkia e zbaton edhe në bazë të parimeve themelore të funksionimit të një qeverisje demokratike dhe të shtetit të së drejtës, parime të tilla si: parimi i transparencës, gjithëpërfshirës, zbatimit të ligjshmërisë, subsidiaritetit etj.

Dëgjesat dhe konsultimet publike mbi projektbuxhetin me pjesëmarrje u realizuan edhe këtë vit në 24 njësitë administrative, ku u paraqitën projektet e nisura tanimë, të cilat do të vijojnë edhe gjatë vitit 2019, si edhe ato risi në punë dhe investime publike, të cilat parashikohen të financohen dhe realizohen gjatë vitit të ardhshëm. Gjithashtu u morrën në konsideratë kërkesat dhe sugjerimet e banorëve për përmirësimin e cilësisë së jetesës sipas nevojave për secilën njësi.

U realizua sondazhi për qytetarët, qëllimi i të cilit ishte të evidentojë mendimin qytetar rreth fushave dhe zërave të investimeve, të propozuara nga Bashkia e Tiranës në projektbuxhetin e vitit 2019.

Nga totali i të intervistuarve pjesëmarrës në këtë sondazh, **34%** e tyre ishin femra dhe **66%** meshkuj. Vihet re që grup-moshat 26 – 55 vjeç kanë përqindjen më të lartë të pjesëmarrjes, konkretisht **71%**.

Njësitë me pjesëmarrje më të lartë në dëgjesat publike janë: Njësia Administrative Nr.5 me 150 intervista të kryera gjatë dëgjesës, Njësia Administrative Farkë me 117 të intervistuar dhe Njësia Administrative Nr.9 me 115 të intervistuar.

Gjithashtu, pjesëmarrje të lartë ka pasur edhe në Njësitë Administrative Nr.4 dhe Vaqarr me nga 100 intervista secila si edhe Njësia Administrative Pezë me 96 të intervistuar.

Nevojat dhe sugjerimet e ardhura nga qytetarët variojnë në funksion të zonave të banimit dhe problematikave të ndryshme që këto paraqesin, sipas shembujve të mëposhtëm:

Në Njësinë Administrative Nr.1, vërehet se zërat më të nevojshëm janë konsideruar gjelbërimi 57%, furnizim me ujë të pijshëm 54%.

Në Njësinë Administrative Nr. 2, qytetarët janë shprehur se investimet në këtë njësi duhet të jenë më së shumti për infrastrukturë rrugore 68% dhe kënde lojërash e hapësira çlodhëse 61%.

Në Njësinë Administrative Nr. 3, vërehet se zërat më të nevojshëm janë konsideruar pastrimi i mbetjeve urbane 53%, gjelbërimi 49%, parkimi dhe terrene sportive përkatësisht nga 41%.

Për sa i përket investimeve **në Njësinë Administrative Nr.4**, vërehet se kryesisht shihen si parësore gjelbërimi 63%, rrjeti i biçikletave 46%, strehimi dhe shërbimi social 44%.

Në Njësinë Administrative Nr. 5, sipas të anketuarve prioritet janë këndet e lojërave dhe hapësirat çlodhëse dhe parkime 47% secila, gjelbërimi dhe infrastruktura rrugore 45% secila.

Në Njësinë Administrative Nr. 6, rezulton parësore nevoja për ndërhyrje në infrastrukturë rrugore 70%, në rrjetin e ujësjellësit 64% dhe gjelbërim 63%.

Në Njësinë Administrative Nr. 7, konsiderohet si më parësore infrastruktura rrugore me 56% dhe rrjeti ujësjellës dhe kanalizimet përkatësisht me nga 55%.

Nga projeksioni i analizës së të dhënave rezulton se **në Njësinë Administrative Nr. 8** konsiderohen si prioritare nevoja për vende parkimi 56% dhe ndërhyrje në infrastrukturë rrugore 52%.

Në Njësinë Administrative Nr.9, është evidentuar si parësore nevoja për punësim dhe formim profesional 53% dhe shkolla të reja veçanërisht në zonën e Bregut të Lumit 41%.

Në Njësinë Administrative Nr. 10, banorët e kësaj njësie e konsiderojnë si zë parësor nevojën për vende dhe hapësira parkimi 58% dhe ndërhyrje në rrjetin e ujësjellësit dhe furnizimit me ujë të pijshëm 40%.

Për sa i përket nevojave për investime gjatë vitit të ardhshëm, banorët **në Njësinë Administrative Nr. 11** kanë nënvizuar si më emergjente sistemimin e kanalizimeve 81%, infrastrukturë rrugore 76% dhe ndërhyrje në rrjetin ujësjellës 73%.

Banorët e **Njësisë Administrative Nr. 12 dhe Dajt** kanë shënuar si parësore, ndër zërat për investim gjatë vitit 2019, punësimin dhe formimin profesional 51% dhe infrastrukturën rrugore 51%.

Nevojat për investim në optikën e banorëve **të Njësisë Administrative Nr. 13 dhe Farkë** janë më së shumti në punësim dhe formim profesional 84% dhe transport publik 76%.

Të anketuarit e **Njësisë Administrative Nr. 14 dhe Kashar** kanë shënuar si zërin më të rëndësishëm pikërisht sistemimin e kanalizimeve në rrjetin e ujërave të bardha dhe të zeza 86%, furnizimi me ujë të pijshëm nga ujësjellësi 83% dhe infrastrukturë rrugore 73%.

Komuniteti i **Njësisë Administrative Baldushk** ka cilësuar si zë më të rëndësishëm furnizimin me ujë nga Ujësjellësi 90% sistemimin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza 82% dhe infrastrukturë rrugore 80%.

Banorët e **Njësisë Administrative Bërzhitë** kanë konsideruar si investimin kryesor furnizimin me ujë të pijshëm nga ana e Ujësjellësit 69%, sistemimin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe ujërave të zeza 52% dhe infrastrukturë rrugore 51%.

Banorët në **Njësinë Administrative Krrabë** kanë shënuar si parësore në këtë njësi investimet në lidhje me infrastrukturën rrugore 65%, furnizimin me ujë nga Ujësjellësi 62% dhe shkolla 61%.

Për **Njësinë Administrative Ndroq** është konsideruar si nevojë parësore përfshirja në projektbuxhet e ndërhyrjeve në infrastrukturën rrugore 90%, sistemimin dhe kanalizimet e rrjetit të ujërave të zeza dhe të ujërave të bardha dhe tregje e rrjete tregtie të strukturuar 54% secila.

Dëgjesa e zhvilluar në **Njësinë Administrative Petrelë** evidentoi më së shumti nevojat për ndërhyrje në infrastrukturë rrugore 63%, sistemimin e kanalizimeve të ujërave të bardha dhe të zeza 60% dhe furnizimi me ujë të pijshëm nga Ujësjellësi 54%.

Dëgjesa e zhvilluar në **Njësinë Administrative Pezë** dolën në pah më së shumti nevojat për furnizimi me ujë të pijshëm nga Ujësjellësi 60%, sistemimin dhe kanalizimet e ujërave të bardha dhe ujërave të zeza 57%.

Në **Njësinë Administrative Shëngjergj** më së shumti janë shprehur nevojat për furnizimi me ujë të pijshëm nga Ujësjellësi 71% dhe ndërhyrje në infrastrukturë rrugore gjithashtu me 71%.

Në **Njësinë Administrative Vaqarr** janë shprehur nevojat për furnizim me ujë të pijshëm nga Ujësjellësi 58% dhe sistemimin dhe kanalizimet e ujërave të bardha dhe ujërave të zeza 55%.

Nga dëgjesa në **Njësinë Administrative Zall Bastar** nevojat kryesore janë shprehur për infrastrukturë rrugore 87%, sistemimin dhe kanalizimet e ujërave të bardha e të zeza dhe furnizimi me ujë të pijshëm nga Ujësjellësi 73%.

Për sa më sipër, sugjerimet e ardhura nga qytetarët variojnë në funksion të zonave të banimit dhe problematikave të ndryshme që këto paraqesin:

Në njësitë administrative urbane kërkesat janë të shumta për sistemim, asfaltim dhe ndriçim rrugësh, ndërtim shkollash, kopshtesh dhe çerdhesh por edhe për punësim dhe nxitje të bizneseve si edhe më shumë vende parkimi.

Në njësitë administrative rurale kërkesat janë më të shumta për kanalizime, mirëmbajtjen e shkollave dhe kopshteve, përmirësimin e transportit apo largimin e mbetjeve në disa njësi.

Prioritetet afatmesme të reflektuara në PBA 2019-2021 mbështeten në kërkesat e qytetarëve të Tiranës, në Programin e Kryetarit të Bashkisë së Tiranës për mandatin 2015-2019 dhe në Strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë.

➤ **Prioritetet e Programit Buxhetor Afatmesëm:**

Objektivi themelor i PBA-së 2019-2021 do të jetë garantimi i zhvillimit të qëndrueshëm të Tiranës, për të përmirësuar jetesën e brezave të sotëm e për të garantuar mirëqenien e brezave të ardhshëm.

Programet Buxhetore të tre viteve të shkuara kanë arritur tashmë objektivat e rikthimit të Tiranës në punë dhe kthimit të saj në një qytet të jetueshëm. Kanë përfunduar disa nga projektet e mëdha strategjike; është ndërhyrë në pjesën dërrmuese të lagjeve të qytetit me projekte rigjenerimi urban; është siguruar pastërtia e qytetit dhe reduktuar ndotja; është shtuar sipërfaqja e gjelbër; është përmirësuar ndjeshëm infrastruktura në të gjithë çerdhet e kopshtet e qytetit; janë krijuar hapësira të reja rekreacionale; është rigjallëruar jeta kulturore dhe masivizimi i sporteve.

Në Strategjinë 5 vjeçare për Zhvillimin e Qëndrueshëm të Bashkisë Tiranë, në të cilën është mbështetur hartimi i buxhetit për tre vitet e ardhshme, janë parashikuar 5 qëllimet kryesore të zhvillimit, të zbërthyer në disa objektiva specifike:

1. Përmirësimi i infrastrukturës urbane:
 - Rehabilitimi dhe mobilimi urban i njësive;
 - Përmirësimi i rrjetit rrugor urban, me focus të posacëm tek korsitë e bicikletave dhe trotuarët;
 - Përmirësimi i hapësirave publike, sipërfaqeve të gjelbra, ndricim etj;
 - Krijimi dhe rehabilitimi i infrastrukturës së rrjeteve inxhinierike.
2. Arsimi për të gjithë:
 - Ndërtimi i shkollave të reja;
 - Përmirësimi i infrastrukturës në objektet arsimore;
 - Rritja e sigurisë në rrugë e në objektet shkollore.
3. Zhvillimi i Ekonomisë Green:
 - Nxitja e zhvillimit rural dhe turizmit dhe ndihmesë bujqësisë;
 - Nxitja e zhvillimit ekonomik, punësimin e sipërmarrjes;
 - Zhvillimi i qëndrueshëm i turizmit.
4. Tirana për të gjithë:
 - Nxitjen e mobilitetit alternativ dhe të qëndrueshëm për rritjen e aksesueshmërisë;
 - Përmirësimi i transportit publik duke futur dhe teknologjitë e reja;
 - Rritjen e kapacitetit të parkimit në qytet dhe përdorimin efiçent të hapësirave ekzistuese;
 - Përmirësimin e shërbimit të varrezave publike;
 - Ofrimit të shërbimeve sociale cilësore;
 - Rritjes së sipërfaqeve të gjelbra e parqeve dhe shtimit të hapësirave rekreacionale;
 - Nxitjes së jetës kulturore e sportive në qytet;
 - Mbrojtjes së mjedisit dhe reduktimit të ndotjes;
 - Mbeshtetje politikave rinore dhe zhvillimit të karrieres.
5. Qeverisja e mirë:
 - Përmirësimi i shërbimeve ndaj qytetarëve dhe biznesit;
 - Rritjen e transparencës dhe gjithëpërfshirjes së qytetarëve dhe komuniteteve në vendimmarrje
 - Administrimin më të mirë të të ardhurave të Bashkisë.

➤ **Projekte Strategjike:**

Programet Buxhetore të tre viteve të mëparshme kanë përfshirë një sërë projektsh strategjike, të cilat sot janë të realizuara:

- Projekti i Rigjenerimit Urban të Pazarit të Ri dhe Sheshit Avni Rustemi;
- Projekti i Bulevardit të ri dhe Rehabilitimit të Lumit të Tiranës nga Km. +0.000 deri +0.500;
- Projekti i Ndërtimit të Unazës së Vogël;
- Projekti i Rikonstruksionit të Sheshit Skënderbej;
- Projekti për Rehabilitimin e Parkut të Madh të Tiranës;

Gjithashtu, vijojnë ose janë drejt përfundimit disa projekte të tjera strategjike, të nisura tashmë:

1. Shkollat e reja

Në Bashkinë Tiranës gjenden gjithsej 191 shkolla publike. Sipas studimit të fizibilitetit të realizuar nga Bashkia Tiranë, me qëllim maksimizimin e efikasitetit të shkollave publike, në momentin e realizimit të studimit, rezultoni 61 shkolla me më shumë nxënës se sa kapaciteti i tyre maksimal dhe 57 shkolla që zhvillojnë mësimin me dy turne. Për t'u dhënë një zgjidhje përfundimtare këtyre tre problemeve, studimi konkludoi se është e nevojshme të ndërtohen 17 shkolla të reja, nga të cilat 10 shkolla të ciklit 9-vjeçar, të cilat do të përfshijnë edhe ambiente për kopshte brenda tyre, dhe 7 shkolla të ciklit të mesëm të lartë. Në NJA2 do të ndërtohen 3 shkolla të reja, dy 9 vjeçare dhe një e mesme. Në NJA5 do të ndërtohet një shkollë 9 vjeçare. Në NJA7 do të ndërtohet një shkollë e mesme. Në NJA8 do ndërtohet një shkollë 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në NJA9 do ndërtohet një shkollë 9 vjeçare dhe një e mesme. Në NJA11 do ndërtohen dy shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Në NJA Dajt do ndërtohet një shkollë e mesme. Në NJA Farkë do ndërtohet një shkollë 9 vjeçare. Në NJA Kashar do ndërtohet dy shkolla 9 vjeçare dhe një shkollë e mesme. Të gjitha shkollat 9 vjeçare do të kenë edhe kopësht të integruar. Bashkia Tiranë do të realizojë ndërtimin e 17 shkollave të reja nëpërmjet skemës së Partneritetit Publik Privat, me modelin "Projektim, Financim, Ndërtim, Mirëmbajtje dhe Transferim" ("PFNM"), të ndarë në katër Lote në përputhje me shpërndarjen gjeografike të shkollave që do të ndërtohen. Aktualisht ka përfunduar procesi i përzgjedhjes dhe është lidhur kontrata për fillimin e punimeve për Lotin 1, i cili parashikon ndërtimin e pesë shkollave të reja, tre 9 vjeçare dhe dy të mesme, në Njësitë Administrative Nr.9 dhe Nr.11. Gjithashtu kanë filluar procedurat e konkurimit për tre lotet e tjera, për të cilat pritet fillimi i punimeve brenda vitit 2019.

2. Pylli orbital

Pylli Orbital është një projekt i rëndësishëm për krijimin e një mushkërie urbane për qytetin e Tiranës. Pylli orbital do të shërbejë si një rrip që kufizon zhvillimin e dëndur urban dhe ndan Tiranën urbane me Tiranën periurbane dhe rurale. Plani i Përgjithshëm Vendor planifikon mbjelljen e 2 milion pemëve në këtë brez të ri të gjelbër të qytetit me qëllim që brezat e ardhshëm të qytetareve të Tiranës të kenë akses në një park linear që rrethon qytetin si dhe rritja e dendësisë së gjelbërimit urban pritet të ketë një efekt të drejtëpërdrejt në cilësinë e ajrit. Kjo ndërhyrje, së bashku me sheshin qendror pedonal, rrjetin minimal të biçikletave dhe qendrat e reja urbane të Tiranës pritet të kenë një impakt të rëndësishëm në përmirësimin e cilësisë së jetës dhe shëndetit të banorëve të qytetit tonë.

Pylli Orbital tashmë ka nisur nga puna dhe është sërish pjesë e buxhetit të Bashkisë së Tiranës, ku përveç investimeve të Bashkisë kemi pasur edhe ndihmën e madhe të bizneseve e shoqatave që duan të japin kontributin e tyre për një Tiranë më të gjelbër e më të shëndetshme. Në total në brezin e Pyllit Orbital janë mbjellur tashmë mbi 150 000 pemë pra afro 10% e planit prej 2 milion pemësh deri në vitin 2030. Në fillim të

vitit të ardhshëm përfundojnë edhe 20 Plane të Detajuara Vendore periferike të cilat përcaktojnë parcelat për mbjelljen e pemëve në brezin orbital gjatë 5 viteve të ardhshme.

3. Rrjeti minimal i biçikletave

Rrjeti Minimal i Bicikletave krijon një skelet me korsi të dedikuara dhe të veçuara nga trafiku për qytetarët që përdorin biçikletën si mjetin kryesor të lëvizjes së përditshme. Janë përfunduar korsitë e dedikuara në akset kryesore radiale dhe transversale të qytetit: Rrugën e Dibrës, Rrugën e Durrësit, Rrugën e Kavajës, Bulevardin Zogu i Parë dhe Bulevardin Dëshmoret e Kombit, Unazën e parë dhe të tretë të qytetit, Rrugën Muhamet Gjollës, Sheshin Wilson, Rrugën Ibrahim Rugova, Rrugën Abdyl Frasheri, Rrugën Sulejman Delvina. Në total janë përfunduar mbi 15km korsi bicikletash dhe rrjeti minimal është drejt përfundimit. Me përfundimin e tij në fund të vitit të ardhshëm, strategjia do të ndryshojë në përmirësimin e lidhjeve dytësore me ato arteriale me korsi të dedikuara ose të përmirësuara për bicikletat.

Korsitë e dedikuara të biçikletave rrisin në formë eksponenciale sigurinë në rrugë të drejtuesve të biçikletave si dhe rrisin përdorimin e këtij mjeti në përditshmëri, duke ulur numrin e përdoruesve të automjeteve me një impakt të drejtpërdrejtë në lëvizshmërinë e trafikut si dhe në cilësinë e ajrit dhe shëndetin e qytetarëve të Tiranës.

Aktualisht janë projektuar 34 akse, ekzaktësisht 47 km.

- Janë përfunduar sipas tre mënyrave të ndërhyrjeve të përmendura më sipër 16 akse, pra 28 km, duke përfshirë këtu dhe Parkun e Madh të Liqenit.
- Janë në proces pune 8 korsi të tjera të cilat mbyllen brenda këtij viti, 8 km të tjerë
- Janë projektuar dhe fillon puna për to këtë vit, 10 korsi, pra 11 km

Duhet të përmendim faktin që kjo ndërhyrje deri tani, në 90 % të rasteve ka përdorur hapësirën që zënë parkimet e makinave, dhe jo atë të kalimit të makinave, apo në raste të tjera si rruga e Kavajës dhe Blv. Zogu I, është përdorur trotuari i mesit. Nëse duam një qytet të qëndrueshëm, njerëzor dhe më të sigurt për fëmijët, lëvizja e lirë në këmbë apo me bicikleta e përmirëson çdo ditë tonën.

4. Terminalet e Transportit

Gjatë vitit 2018 përfundoi dhe nisi nga puna Terminali Jug-Lindor i Tiranës, i cili parashikohet të përballojë fluksin e autobusëve dhe furgonëve që hyjnë në Tiranë nga Rr.e Elbasanit, përkatësisht autobusët që vijnë nga Korça, Pogradeci, Librazhdi, Përrenjasi dhe Elbasani si edhe autobusët që vijnë nga Maqedonia. Terminali përfundimor parashikohet të përballojë fluksin e autobusëve dhe furgonëve që hyjnë në Tiranë nga qytetet jugore, veriore dhe veri-lindore. Për këtë terminal, pas përfundimit të procesit të negocimit, është miratuar tashmë në parim nga Këshilli Bashkiak kontrata koncesionare dhe është në fazën e nënshkrimit.

Të dy terminalet do të jenë një ndihmë e jashtëzakonshme në disiplinimin e trafikut në Tiranë dhe lehtësimin e qarkullimit duke shmangur hyrjen në qytet së pari të autobuzëve ndërqytetas e së dyti edhe të shumë prej atyre 60 deri 70 mijë automjete që vizitojnë çdo ditë kryeqytetin nga rrethet, cka do të sigurojnë më pak trafik, por edhe më pak ndotje për Tiranën.

5. Tirana-Një qytet policentrik

Plani i ri i Përgjithshëm Vendor i Tiranës parashihet një qytet me 5 qendra të reja urbane në Kombinat, Kinostudio, Laprakë, tek Bulevardi i ri si dhe në Shkozë. Në këto qendra do të merren masa për nxitjen e investimeve private si dhe investime publike të Bashkisë në infrastrukturë sekondare dhe shkolla të reja si

qendra komunitare me qëllim përqëndrimin e një mase kritike kapitali në një hapësirë qendore urbane. Kjo qasje do të rrisë cilësinë dhe sasinë e shërbimeve të ofruara në këto zona të ndërlidhura mirë me njëra tjetrën me transport publik si dhe me rrjetin minimal të bicikletave. Bashkërendimi i këtyre do të rrisë aksesin e qytetarëve në shërbime pranë vendbanimeve të tyre si dhe do të krijojë disa qendra të reja me karakteristika të ndryshme nga njëra tjetra: qendra universitare, artizanale, artistike, mediatike etj.

Me qëllim hartimin e masterplaneve për Tiranën Policentrike Bashkia Tiranë, do të lanconte gjatë vitit 2018, tre konkurse për tre poliëndrat kryesore të qytetit: Lapranken, Kombinatin dhe Kinostudion. Konkursat do të zhvillohen në rang ndërkombëtar dhe do të finalizohen me një fitues që më pas do të detajojë Planin e Detajuar Vendor të poliëndrës në fjale. PDV e këtyre zonave do të detajojnë përdorimin e tokës dhe do të incentivojnë investimin privat, por njëkohësisht do të vendosin edhe projektet kryesore të punëve publike për tu implementuar në këto zona me qëllim përqëndrimin e një mase kritike investimi publik dhe privat dhe aktivizimin e tyre si qendra të reja të qytetit. Si pasojë e punës komplekse të nevojshme për hartimin e detyrave të projektimit për zhvillimin e një gare të qartë dhe të mirëinformuar nga konteksti, me kontributin e cmuar të partnerëve ndërkombëtarë si Harvard University, lancimi i konkurseve është shtyrë për në fillim të vitit 2019 me qëllim përfundimin e tyre deri në fund të vitit të ardhshëm.

6. Ndërtimi i Bulevardit Verior të Tiranës dhe Punimet Civile Përkatëse

Bulevardi i Ri - Momentalisht ka përfunduar ndërtimi i Parkimi Nëntokësor si dhe ndërtimi i segmentit të parë nga km 0+000 deri në km 0+400, të cilat janë duke u shfrytëzuar nga qytetarët e Tiranës. Ndërtimi i Parkimit Nëntokësor i ka shtuar qytetit të Tiranës rreth 305 vendparkime të reja, të cilat po menaxhohen nga Bashkia Tiranë. Gjithashtu është punuar në segmentin e dytë nga km 0+400 deri km 0+800 ku me përfundimin e shtresave asfaltike do të bëhet dhe hapja së shpejti e këtij segmenti për qytetarët e Tiranës. Po vazhdojnë punimet në segmentin e tretë nga km 0+800 deri në km 1+250 ku ka përfunduar rreth 80% e punimeve të ndërtimit. Bashkia Tiranë, në bashkëpunim me Fondin e Abu Dhabit, ka rishikuar projektin e Bulevardit, duke prezantuar dhe projektin e ri për Parkun Qendror të Tiranës, i cili nuk ishte i parashikuar në projektin e vjetër.

Njëkohësisht këtë vit përfundoi edhe hartimi i Planit të Detajuar Vendor të të gjithë Bulevardit të Ri, me qëllim nxitjen e zhvillimit në këtë zonë të Tiranës, dhe rikuperimin e fondeve të investuara nëpërmjet taksës së ndikimit në infrastrukturë.

Rehabilitimi i Lumit të Tiranës – Deri më sot janë realizuar në masën 98% zërat e punimeve civile dhe hidraulike të kontratës së parë të Rehabilitimit të Lumit që përfshin segmentin nga km 7+100 për të dyja drejtimet, atë të Tiranës dhe Paskuqanit. Kontrata vijuese përfshin km 1+300 dhe kanë përfunduar punimet civile dhe hidraulike në masën 98%. Deri në fund të këtij viti pritet të mbyllen të gjitha punimet civile dhe hidraulike për të dyja kontratat në masën 100% si dhe të vazhdohet me gjelbërimin e zonave të parashikuara

7. Kopshti Zoologjik

Kopshti Zoologjik është një hapësirë që prej dekadash ka patur nevojë për ndërhyrje thelbësore për të lehtësuar maksimalisht vuajtjet e gjallesave që e popullojnë atë e njëkohësisht për ta transformuar në një hapësirë të re edukative për qytetarët e mbi të gjitha fëmijët e kryeqytetit.

Projekti ynë për kopshtin zoologjik e transformon atë në një hapësirë moderne, ku kafshët nuk janë në kafaz, përkundrazi ato jetojnë në habitatin e tyre dhe janë vizitorët ato që janë të kufizuar nga kafazi. Transformimi gjithashtu e sheh hapësirën si një mundësi më tepër për të edukuar fëmijët duke ulur numrin e kafshëve ekzotike (që kanë kosto dhe standarte shumë më të larta se kafshët e tjera) dhe rritur numrin e kafshëve të fermës, të cilat janë edhe më të afërshme, pra projekti i afrohet asaj që ndërkombëtarisht quhet petting-zoo – një kopsht zoologjik interaktiv.

Tjetër pikë e rëndësishme e këtij projekti është edhe zgjerimi dhe ndërlidhja me Kopshtin Botanik. Në fazën e fundit të implementimit kopshtet lidhen me një hapësirë të nëndheshme që shërben edhe si një hapësirë për fluturat ose një miniakuarium i nëndheshëm. Në këtë mënyrë itinerari i Kopshtit Zoologjik zmadhohet dhe bashkohet edhe me larmishmërinë e florës së Kopshtit Botanik. Ky projekt është parashikuar në buxhetin e vitit 2019.

8. Piramida

Ndërkohë që Tirana është gati katërfishuar në popullsi pas viteve '90, dhe njohu një bum në ndërtim dhe zhvillim urban, paradoksalisht hapsirat publike kushtuar artit dhe kulturës apo shtëpitë e rinisë, dikur ekzistuese, pothuajse u zhdukën. Piramida ka qenë objekti i fundit që arriti të luajë një rol publik sa i përket jetës artistike, kulturore dhe intelektuale. Në fakt Piramida jo vetëm që ishte objekti i fundit, por ishte dhe një pikë nevralgjike e jetës intelektuale të qytetit mbasi me hapësirat e shumta që ofronte kishte mundësi që të mbulonte nevojat e thujtë të gjitha disiplinave por dhe grup moshave.

Është sot i pamohueshëm vakumi që mbyllja e këtij objekti ka krijuar për jetën intelektuale të qytetit si dhe kultivimit të brezave të rinj me dëshirën për artin dhe kulturën.

Puna për transformimin e Piramidës në një qendër që përziën artin, kulturën, teknologjinë e informacionit dhe edukimin është finalizuar në bashkëpunim me Fondin Amerikan Shqiptar të Zhvillimit, qendrën TUMO Armeni dhe arkitektet e mirënjohur të MVRDV.

Në vitin e ardhshëm parashikohet përfundimi i projekt zbatimit nga MVRDV financuar nga AADF dhe fillimi i punimeve për transformimin e kësaj godine në një nga ambjentet më inovativ të qytetit të Tiranës, nëpërmjet financimit të përbashkët të Qeverisë Shqiptare, Bashkisë së Tiranës dhe AADF.

III. 1. PARASHIKIMI I TË ARDHURAVE TË BASHKISË SË TIRANËS PËR PERIUDHËN 2019-2021

Burimet e financimit të buxhetit për Bashkinë e Tiranës, përbëhen nga:

- I. Të ardhurat e veta;
- II. Transferta e pakushtëzuar;
- III. Transferta e kushtëzuar;
- IV. Huamarrja e qeverisjes vendore;

Për vitin 2019 të ardhurat nga taksat e tarifave vendore janë parashikuar në vlerën e 13.359.030.000 lekë, me një rritje prej 2.9 % krahasuar me parashikimin e vitit 2018.

Në vitin 2019, masa e transfertës së pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës është rritur me 9 % ose 210.092.419 lekë krahasuar me atë të miratuar për vitin 2018 të, duke arritur vlerën 2.348.723.419 lekë.

Për vitin 2019, Transferta e Pakushtëzuar përbëhet nga:

- **Transferta e pakushtëzuar e Përgjithshme** niveli i së cilës bazohet në përcaktimin se madhësia e transfertës së pakushtëzuar për vitin 2019, në nivel kombëtar, është 1% e Produktit të Brendshëm Bruto të parashikuar për vitin 2019 dhe
- **Transferta e pakushtëzuar Sektoriale** e cila përfaqëson transfertën në përfundimin e periudhës tranzitore për financimin me transferta specifike të funksioneve të decentralizuara dhe që rregullon konvertimin e transfertave specifike për funksionet e decentralizuara rishtazi në nivel vendor në transfertë të pakushtëzuar sektoriale.

Kështu, pjesë e transfertës së pakushtëzuar të parashikuar për vitin 2019, janë shtuar edhe fondet për financimin e funksioneve të reja të cilat për periudhën 2016-2018, janë financuar nëpërmjet transfertave specifike. Duke filluar nga 1 janari 2019, transfertat specifike kthehen në transferta të pakushtëzuara sektoriale të cilat përdoren në autonomi, duke ruajtur ndarjen sektoriale, nga njësitë e vetëqeverisjes vendore.

Në vija të përgjithshme parashikimi i të ardhurave për vitet 2019 - 2021, paraqitet me këto vlera:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Plani 2018	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Të ardhura të taksueshme	8,782,500,000	8,972,750,000	8,905,255,000	8,874,260,000
Të ardhura jo tatimore	4,194,750,000	4,386,280,000	4,454,880,000	4,494,280,000
	12,977,250,000	13,359,030,000	13,360,135,000	13,368,540,000
Transferta e Pakushtëzuar e përgjithshme	2,138,631,000	2,348,723,419	2,375,988,354	2,638,173,933
Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale	992,080,016	1,127,433,601	0	0
	3,130,711,016	3,476,157,020	2,375,988,354	2,638,173,933
Të ardhura të mbartura	1,200,000,000	1,500,000,000	1,500,000,000	400,000,000
Totali	17,307,961,016	18,335,187,020	17,236,123,354	16,406,713,933

Referuar legjislacionit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, për paketën fiskale vendore të Bashkisë Tiranë, për mbledhjen e të ardhurave janë përcaktuar edhe strukturat përkatëse, si më poshtë:

- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore;
 - Tirana Parking;
 - Strukturat e Aparatit të Bashkisë;
 - Agjentët tatimorë.
- Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore, është struktura kryesore, për mbledhjen dhe rakordimin e të gjitha të ardhurave të Bashkisë së Tiranës, e cila administron plotësisht procesin e mbledhjes së të ardhurave nga taksat e tarifave për kategorinë e bizneseve; si dhe arkëton dhe ndjek procesin e rakordimit për të ardhurat që mbidhen nga struktura të tjera të Bashkisë dhe nga Agjentët Tatimorë.
- Tirana Parking, është struktura e specializuar vetëm për mbledhjen e tarifës së parkimit sipas VKB Nr.48 datë 11.11.2016 “Për krijimin e Tirana Parking si institucion në varësi të Bashkisë Tiranë për administrimin e shërbimit të parkimit publik me pagesë”.
- Strukturat e Aparatit të Bashkisë janë të angazhuara në administrimin e tarifave të shërbimit që aplikon vetë institucioni si dhe në taksat që zbatohen direkt prej tyre, arkëtimi i të cilave bëhet me tej nga DPTTV.
- Agjentët tatimorë të përcaktuar sipas ligjit dhe vendimeve të Këshillit Bashkiak, janë:
- Drejtoria Rajonale Tatimore, për arkëtimin e Tatimit të Thjeshtuar mbi Fitimin e BV;
 - DRSHTRR, për arkëtimin e taksës vjetore të mjeteve të përdorura;
 - ZVRPP, për arkëtimin e taksës për kalimin e së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme;
 - Ujësjellës Kanalizime Tiranë Sha, për arkëtimin e taksës së ndërtesës, taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore dhe tarifës së pastrimit nga kategoria Familjarë;

Në mënyrë të detajuar të ardhurat nga taksat dhe tarifave vendore për parashikimin e vitit 2019 në Bashkinë e Tiranës, paraqiten si më poshtë:

TAKSA VENDORE

A) Taksa mbi ndërtesën.

Taksa e pasurisë është ndër burimet më me peshë në buxhetin e Bashkisë Tiranë dhe përbën 18 % të totalit të të ardhurave të veta.

Me ndryshimet e fundit ligjore, të datës 1 Prill 2018, taksa e ndërtesës ka marrë një tjetër vlerësim, duke u mbështetur tek vlera e banesave. Niveli i taksës i shprehur në përqindje si për ndërtesat që përdoren për banim në masën 0.05% edhe për ndërtesat që shfrytëzohen për veprimtari ekonomike në masën 0.2%, aplikohet mbi vlerën e ndërtesës (çmimi i shumëzuar me sipërfaqe).

Për këtë qëllim, Ministria e Financave dhe Ekonomisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Taksës së Pasurisë, në bashkëpunim me institucione të tjera qëndrore si, OSHEE, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Cicile, ZVRPP, etj., është në proces për finalizimin e ngritjes së bazës së të dhënave, krijimin e Kadastrës Fiskale si informacioni bazë i domosdoshëm për përlogaritjen dhe mbledhjen e të ardhurave nga taksa e ndërtesës.


NJQV do të jenë të ngarkuar me përditësimin e të dhënave të pasqyruar në programin e kadastrës fiskale si dhe me ngarkimin e të dhënave të reja mbi bazën e vetëdeklarimit të qytetarëve apo me verifikimin e saktësimin e informacioneve në terren dhe pasqyrimin e saktë në programin e kadastrës fiskale.

Nga ana e tyre NJQV kanë filluar të organizohen për menyrën e administrimit të taksës së ndërtesës, në kushtet që nuk është vendosur përzgjedhja e OSHEE si agjent tatimor për të gjitha Njësitë e vetqeverisjes vendore, proces i cili duhet të finalizohet brenda vitit 2018, me qëllim që duke filluar nga janari 2019 të mundësohet aplikimi dhe mbledhja e taksës së ndërtesës konform ndryshimeve ligjore.

Në këtë kontekst, për Bashkinë Tiranë do të vijojë të jetë DPTTV struktura që do të arkëtojë detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitet ekonomik në territorin e Bashkisë Tiranë, ndërsa për detyrimet e kategorisë familjarë do të përzgjidhet Agjenti Tatimor brenda muajit Dhjetor 2018, nëpërmjet vendimit të posacëm për këtë qëllim.

Nëpërmjet strukturës së DPTTV, Bashkia Tiranë ka aplikuar taksën e ndërtesës sipas ndryshime ligjore, për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për aktivitet ekonomik. Gjatë vitit 2018, kjo taksë ka arritur nivelin maksimal të arkëtimit, për kategorinë biznese. Për këtë kategori, performanca në mbyllje të vitit 2018 pritet të jetë rreth 97 % më shumë se në vitin 2015, 16 % më shumë se në vitin 2016 dhe 8 % më shumë se viti 2017, si më poshtë:

Në lekë						
Taksa mbi pasurine	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Biznesi	440,713,939	726,837,103	795,276,949	1,356,525,315	1,457,892,780	1,569,879,307




Për kategorinë e ndërtesave që shfrytëzohen për banim, sipas udhëzimeve të Ministrisë së Financave dhe Ekonomisë, aplikimi i taksës sipas sistemit mbi bazë vlere, do të fillojë në janar 2019.

Edhe për këtë kategori realizimi vijon të jetë i kënaqshëm, pas një rritje drastike në vitin 2016 në krahasim me vitin 2015, ku arkëtimet u shtatëfishuan. Në vitin 2017 arkëtimet sërish u dyfishuan kundrejt atyre të vitit 2016. Viti 2018 shënon arkëtime në të njëjtin nivel me ato të vitit 2017.

Më poshtë paraqitet realizimi në vite i të njëjtës taksë për kategorinë familjare:

Në lekë

Taksa mbi pasurine	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Familjare	14,174,707	29,918,994	16,879,527	116,857,519	216,542,796	220,534,944



Në vitin 2019, të ardhurat nga taksa e ndërtesës janë parashikuar në vlerën 2.410.000.000 lekë. Në këtë parashikim përfshihen të ardhurat nga kategoria familjare dhe kategoria e biznesit, si më poshtë:

Planifikimi i të ardhurave për periudhën 2019 – 2021 merr në konsideratë ndryshimet ligjore për këtë takse. Planifikimi për kategorinë e bizneseve është bërë në bazë të të dhënave të DPTTV, ndërsa për kategorinë familjare në bazë të një vlesërimi paraprak, sipas të dhënave aktuale që disponohen nga Kadastra Fiskale.

Në lekë


Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	2,410,000,000	2,808,000,000	2,840,000,000
- Familjarët	510,000,000	870,000,000	900,000,000
- Subjektet Tregtare	1,900,000,000	1,938,000,000	1,940,000,000

B) Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja.

Taksës së ndikimit në infrastrukturë nga lejet e ndërtimit i nënshtrohen të gjitha subjektet që kërkojnë të pajisen me leje zhvillimore dhe leje ndërtimi për objekte banimi, administrative, prodhimi, shërbimi e tjera.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja paraqitet me një pritshmëri të realizimit rreth 10% më të lartë se në vitin 2017.

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	624,719,373	1,004,842,547	128,325,090	1,234,029,324	3,334,882,679	3,699,201,924



Referuar ecurisë së arkëtimit të taksës por edhe shtrirjes së gjerë të studimeve të detajuara vendore, në kuadër të planit të përgjithshëm vendor, për vitin 2019 dhe në vijim edhe për vitet 2020 – 2021, parashikimet për këtë taksë, paraqiten si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa e ndikimit në infrastrukturë nga ndërtimet e reja	4,000,000,000	3,500,000,000	3,400,000,000

Struktura e ngarkuar për këtë taksë është Drejtoria e Përgjithshme e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, e cila ndërkohë që pranon kërkesat, i shqyrton ato dhe pas miratimit nga Titullari, kryen edhe zbardhjen e kësaj leje kundrejt arkëtimit më parë të vlerës në masën sipas përcaktimeve ligjore.

Vlen të theksohet se në bazë vjetore, volumi i ndërtimit nuk ka ndryshime të theksuara nga viti 2017. Madje është i krahasueshëm me arkëtimin faktik të kësaj takse në vitin 2014. Pra këto të ardhura janë gjeneruar nga ndryshimi i bazës së taksueshme. Suksesi i mbledhjes së kësaj takse edhe në vitin 2018 duke patur parasysh se cmimet në qytetin e Tiranës nuk janë rritur por kanë mbijetuar krahasueshmërisht të njëjta tregon se kjo taksë nuk ka patur asnjë impakt tek qytetari, por ka ulur deri diku fitimin e zhvilluesve, por jo aq sa të disincentivojë apo ulë interesin e tyre për zhvillim. Pra është arritur një balancë midis “vullnetit për të paguar” të biznesit të ndërtimit dhe volumit të ndërtimit që krijon hapësirë rezidenciale për rreth dhjetra mijëra rezidentët e rinj që i shtohen çdo vit Tiranës. Kjo taksë do të vazhdojë të ruajë këtë nivel arketimi në

vitet e ardhshme, aq me tepër duke parashikuar zhvillimet e reja që pritet ti shtohen Tiranës në zonën e mirëplanifikuar të Bulevardit të Ri, ku këtë vit u miratua edhe Plani i Detajuar Vendor nga Këshilli Kombëtar i Territorit – plan ky që i hap rrugë zhvillimit.

C) Taksa e përkohshme për infrastrukturën arsimore.

Taksës së përkohshme për infrastrukturën arsimore i nënshtrohen të gjitha familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

DPTTV arkëton detyrimin e kësaj takse nga subjektet që realizojnë aktivitete ekonomike në territorin e Bashkisë Tiranë, ndërsa detyrimi nga kategoria familjarë arkëtohet nga agjenti tatimor i përzgjedhur për këtë qëllim, UKT Sha.

Taksa e përkohshme e infrastrukturës arsimore ka një realizueshmëri të kënaqshme që nga koha e hyrjes në fuqi, në vitin 2016. Në vitin 2017 të ardhurat e arkëtuara nga kjo taksë për kategorinë e bizneseve janë rritur me 17% në krahasim me vitin 2016 (viti i parë i aplikimit) dhe pritet të kenë një rritje prej 6% në vitin 2018 krahasimisht me 2017. Për kategorinë familjarë arkëtimet kanë pësuar rritje me 88% në vitin 2017, krahasimisht me vitin 2016 dhe pritet të ketë arkëtime në të njëjtin nivel të vitit 2017, për vitin 2018.

Për periudhën 2019 – 2021, parashikimi i të ardhurave nga kjo taksë e përkohshme, është si vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa e përkohëshme për infrastrukturën Arsimore	860,000,000	876,000,000	892,000,000
Familjarët	310,000,000	316,000,000	322,000,000
Subjektet Tregtare	550,000,000	560,000,000	570,000,000

D) Taksa e tabelës.

Vendosja e tabelës për qëllim identifikimi është detyrim për të gjithë subjektet, me përjashtim të ambulanteve, subjekteve të transportit dhe profesionet e lira.

Taksa e tabelës përbëhet :

- I. Tabelë për qëllime identifikimi të trupëzuara ose jo brenda territori ku zhvillon veprimtarinë e biznesit dhe që nuk përdoret për të reklamuar veprimatrinë e të tretëve (ku shënohet emri dhe ose aktiviteti i biznesit:
 - ✓ Tabelë deri në 2 m²:
 - ✓ Tabelë mbi 2 m²:
- II. Tabelë për qëllime identifikimi jashtë territorit ku zhvillohet veprimtaria e biznesit në formën dhe përmasat e tabelës për orientim.
- III. Tabelë për qëllime reklamimi e lëvizshme/e palëvizshme deri në tavanin 35 m²:


- ✓ Tabelë e thjeshtë me/pa ndricim;
- ✓ Tabelë elektronike.

IV. Tabelë në funksion të ekspozimeve të ndryshme të hapura, panaire, spektakle, stenda reklamuese, banderola, etj. (të të gjitha përmasave)

Ecuria e taksës së tabelës ndër vite pasqyrohet në tabelën më poshtë. Arkëtimet nga kjo taksë janë rritur çdo vit, ku në vitin 2017 është shënuar një rritje prej 54% në krahasim me vitin 2015, ndërsa në vitin 2018 paraqiten të qëndrueshme kundrejt vitit të mëparshëm.

në lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Taksa e tabelës dhe reklamës	241,190,949	227,080,832	225,377,938	309,949,842	345,930,032	347,334,980



Konkretisht, referuar realizimit të pritshëm të të ardhurave për vitin 2018 dhe nivelit të taksës së miratuar sipas ligjit, parashikimi i të ardhurave për vitet 2019 – 2021, paraqitet në tabelën si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa e tabelës	400,250,000	408,255,000	416,260,000
Tabelë identifikuese/sinjalizuese	250,000	255,000	260,000
Tabelë reklamuese	400,000,000	408,000,000	416,000,000

E) Taksa për fjeten në hotel.


Struktura e ngarkuar për mbledhjen e kësaj takse është Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore. Llogaritja e kësaj takse, bazuar në legjislacionin në fuqi, bëhet sipas ndarjes në dy kategori:

- Subjekte Hoteleri me 4 – 5 yje me nivel takse për 350 lekë/dhoma;
- Subjekte Hotele, Bujtime, Fjetinë, Motel dhe çdo njësi tjetër akomoduese sipas përcaktimeve të ligjit për turizmin në nivel takse për 140 lekë/dhoma

Megjithë problemet për shkak të mosplotësimin të kuadrit ligjor në vlerësimin mbi bazë yjesh për hotelet, gjatë vitit 2018 është shënuar një rritje prej 3% në krahasim me arkëtimet e vitit 2017. Në krahasim me vitin 2015 e me herët, arkëtimet nga kjo taksë janë rritur mbi 70%.

Në lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Taksa e fjetjes në Hotel	39,845,616	42,060,817	50,480,613	67,327,716	83,170,711	85,716,403



Parashikimi i të ardhurave nga taksa e fjetjes në hotel për vitet 2019 - 2021, është si me poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa e fjetjes në hotel	85,000,000	86,000,000	87,000,000

F) Taksa mbi truallin.

Baza e taksës mbi truallin është sipërfaqja e truallit në m², në pronësi apo përdorim të taksapaguesit.

Sipërfaqja e truallit në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Në rast të mungesës së dokumentacionit të pronësisë, përdoruesi i truallit bën një vetëdeklarim të sipërfaqes së truallit në përdorim.

Bashkitë ndodhen në mungesë të bazës së të dhënave për këtë taksë si dhe në pritje të akteve ligjore plotësuese për taksimin e truallit, si një taksë qendrore për t'u aplikuar nga njësitë vendore dhe si rrjedhim, planifikimi bazohet në të dhëna historike dhe trendin vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit.

Për vitin 2019 dhe dy vitet në vijim 2020 – 2021, parashikimi të ardhurave nga kjo taksë jepet në talelë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa mbi truallin	60,000,000	61,000,000	62,000,000

G) Taksa mbi tokën bujqësore.

Baza e taksës mbi tokën bujqësore është sipërfaqja e tokës bujqësore, në hektar, në pronësi të taksapaguesit. Sipërfaqja e tokës në pronësi përcaktohet sipas dokumenteve që e vërtetojnë atë. Për çdo kategori minimale të tokës bujqësore, Këshilli Bashkiak mund të miratojë nën-kategorizime. Vlera e taksës në lekë/hektar/vit, miratuar me akte ligjore sipas bashkive dhe kategorisë së tokës, paraqitet në tabelë:

Kategoritë e tokës bujqësore	Lekë/ha/vit
I	5 600
II	4 900
III	4 200
IV	3 600
V	3 000
VI	2 400
VII– X	1 800

Aktualisht, në mungesë të një baze të dhënash mbi tokën bujqësore, planifikimi bazohet në të dhënat historike të arkëtimit dhe trendit vjetor përkatës të ndryshimeve të arkëtimit për këtë taksë. Bashkia e Tiranës është duke realizuar rregjistrin e fermerëve të Tiranës, çka në vijim do të jetë një bazë e mirë të dhënash jo vetëm për t'u ardhur në ndihmë fermerëve, por dhe për efekt të taksimit të drejtë.

Parashikimi i të ardhurave nga taksa mbi tokën bujqësore për vitet 2019 –2021, paraqitet si më poshtë.

Në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa mbi tokën Bujqësore	50,000,000	51,000,000	52,000,000

AGJENTË TATIMORË JASHTË BASHKISË TIRANË

H) Taksa e kalimit të së drejtës së pronësisë për pasuritë e paluajtshme.

Mbledhja e kësaj takse realizohet nga strukturat e ZVRPP, agjent tatimor që përfiton edhe 3% të shumës së arkëtuar.

Të dhënat për parashikimin e kësaj takse merren nga ZRRPP e cila finalizon dhe evidenton të gjitha rastet e transkriptimit të pronës duke llogaritur detyrimin si për llojin e pronësisë por dhe vlerën e detyrimit mbi bazën e sipërfaqes së taksueshme. Kështu detyrimi për banesat është në nivelin 1.000 lekë/m² dhe për objektet e biznesit është 2.000 lekë/m². Numri i objekteve që transkriptohen është i lidhur ngushtë me lejet e

shfrytëzimit të lëshuara nga njësitë vendore për objektet e përfunduara por dhe nga ALUIZNI për ato të legalizuara.

Ecuria në vite për këtë taksë paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	296,049,524	240,109,009	325,790,581	366,078,762	299,939,349	298,536,790

Në lekë

Bazuar në ecurinë faktike të viteve të kaluara dhe në informacionin nga ZVRPP, parashikimi për vitet 2019 – 2021, paraqitet si më poshtë:

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	300,000,000	300,000,000	300,000,000

në lekë

I) Taksa vjetore e mjeteve të përdorura

E ardhura nga taksa, mblidhet nga strukturat e Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor (Drejtoria Rajonale Tiranë) para kryerjes së kontrollit teknik vjetor të detyrueshëm të mjetit.

Procedura e ndarjes së të ardhurave me buxhetet e njësive të qeverisjes vendore përcaktohet me vendim të Këshillit të Ministrave, bazuar në numrin e mjeteve të regjistruara sipas njësive të qeverisjes vendore por e konvertuar në përqindje, në masën 25 % e të ardhurave të realizuara për çdo muaj nga agjentët tatimor DPSHTRR.

Realizimi i të ardhurave nga taksa e mjeteve të përdorura deri në vitin 2018, paraqitet në tabelën e mëposhtme:

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	320,249,987	279,468,676	229,126,388	280,082,106	285,325,027	342,774,766

në lekë

Parashikimi për vitet 2019 – 2021, paraqitet si vijon:

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa vjetore e mjeteve të përdorura	380,000,000	385,000,000	390,000,000

në lekë

J) Tatimi mbi të ardhurat personale

Të ardhurat nga tatimi mbi të ardhurat personale të NJQV përfaqësojnë vlerën 2% e totalit të të ardhurave nga Tatimi mbi të ardhurat personale që arkëtohet nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve.

Vlen të bëjmë me dije se për vitin 2018, nuk është evidentuar asnjë e ardhur nga ky tatim, ku strukturë mbledhëse është DPT. Pritet të finalizohen udhëzimet dhe procedurat për këtë qëllim nga Ministria e Financave dhe Ekonomisë që të bëhet i mundur brenda vitit 2018, kalimi në favor të BT i vlerës përkatëse sipas përcaktimeve ligjore.

Bashkia e Tiranës, për vitet 2019 – 2021, nisur nga llogaritjet e përafërta mbi përkatësinë e pjesës takuese nga totali i parashikuar nga DPT, ka parashikuar të ardhurat për BT, si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Taksa mbi të ardhurat personale	257,500,000	260,000,000	265,000,000

K) Tatim i thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Çdo biznes, i cili realizon gjatë vitit fiskal një qarkullim më të vogël ose të barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për biznesin e vogël.

Shkalla tatimore e aplikueshme mbi fitimin e tatueshëm, për tatimpaguesit që i nënshtrohen tatimit të thjeshtuar mbi fitimin e biznesit të vogël, me qarkullim vjetor nga 5 (pesë) deri në 8 (tetë) milionë lekë, është 5%. Tatimi i thjeshtuar mbi fitimin, për tatimpaguesit me qarkullim vjetor nga 0 (zero) deri në 5 (pesë) milionë lekë, është 0 (zero) lekë në vit.

Struktura e ngarkuar për vjeljen e taksës vendore mbi biznesin e vogël është Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve nëpërmjet drejtorive rajonale tatimore të cilat transferojnë të ardhurat nga TTHF e biznesit të vogël në llogarinë e Bashkisë së Tiranës sipas afateve të përcaktuara në ligj.

Bazuar në ecurinë e mbledhjes së tatimit, pritshmërinë e vitit 2018 dhe në rivlerësimin e pritshëm ligjor të tij, parashikimi për vitet 2019 – 2021, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	170,000,000	170,000,000	170,000,000

TARIFA VENDORE

L) Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave.


Tarifës së Pastrimit i nënshtrohen të gjithë familjet, personat fizikë ose juridikë, vendas ose të huaj, që banojnë dhe ushtrojnë veprimtari ekonomike brenda territorit të Bashkisë së Tiranës.

Tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave mblidhet nga dy struktura, përkatësisht nga Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore për kategorinë e biznesit dhe Ujësjellës – Kanalizime Tiranë Sha për kategorinë familjarë.

Vlen të theksohet se niveli i arkëtimit për kategorinë familjare ndër vite i kësaj tarife, është mbledhur nga struktura të ndryshme sipas përkatësisë të miratuar me vendim të KB, çka ka pasqyruar edhe diferenca të theksuara në kohë. Kështu, deri në vitin 2011 ky detyrim është mbledhur nga ish-Njesitë Bashkiake të Tiranës dhe rezultatet e arkëtimit kanë qenë mjaft të ulta. Mbas vitit 2012 e në vijim tarifa e pastrimit dhe largimit të mbeturinave po vijon të mbidhet nga agjenti tatimor UKT Sha t, periudhë e cila shënon një rritje të ndjeshme të të ardhurave nga kjo tarifë, megjithëse jo në nivelin e kapacitetit. Si pasojë e reformimit të UKT sha, forcimit të administratës së institucionit dhe shtrirjes së kontrollit në të gjithë territorin e ri të Bashkisë së Tiranës, në vitin 2016 u arkëtuan thuajse dyfishi i të ardhurave të vitit 2015 nga kjo tarifë, ose 1.9 herë më shumë. Arkëtimi ka vijuar në nivele të qëndrueshme me një pritshmëri më të lartë për vitin 2018.

Paraqitja në vite si më poshtë:


	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Tarifa e pastrimit Familjarë	337,189,756	339,808,610	353,205,579	680,162,260	660,070,341	706,400,213



Lidhur me tarifën e pastrimit dhe largimit të mbeturinave nga kategoria biznesi, vihet re një ecuri pozitive që tregon një rritëm në rritje e arkëtimit në tre vitet e fundit, si rrjedhim i mirëadministrimit të saj nga strukturat e DPTTV.

E njëjta taksë për kategorinë biznese paraqitet në tabelën dhe grafikun në vijim:

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Tarifa e pastrimit Subjekte	417,910,122	469,930,528	478,459,466	929,032,867	1,055,409,334	1,225,399,605



Për vitin 2019, parashikimi i arkëtimit të tarifës së pastrimit për subjektet dhe kategorinë familjarë, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Tarifa e pastrimit	2,070,000,000	2,110,000,000	2,129,000,000
- Familjarët	730,000,000	744,000,000	759,000,000
- Subjektet Tregtare	1,340,000,000	1,366,000,000	1,370,000,000

Parashikimi i të ardhurave nga subjektet e biznesit është mbështetur në kapacitetin e taksapaguesve që përfaqësojnë numrin e subjekteve të evidentuara aktiv dhe nivelin e tarifës për vitin ushtrimor, të ardhura që trajtohen nga strukturat e DPTTV, e cila në bashkëpunim me njësitë administrative do të kryejnë në kohë njoftimet e subjekteve për detyrimin por në veçanti do të ndjekin edhe mbledhjen e tyre.

M) Tarifa për zënien e hapësirave publike.

Tarifa për zënien e hapësirave publike llogaritet për sipërfaqen në m² të shfrytëzuar nga subjekti për ushtrimin e aktivitetit të indeksuar sipas zonës së vendndodhjes dhe nivelit të taksës për njësi të miratuar nga Këshilli Bashkiak.


Tarifa për zënien e hapësirave publike përbëhet nga:

- Zënia e hapësirës publike me kangjella, platforma, vazo, etj
- Zënia e hapësirës publike në tregjet publike.
- Zënia e hapësirës publike për organizimin e spektakleve ose panairove të ndryshme.

Arkëtimet nga tarifa e zënies së hapësirës publike kanë pësuar një rritje shumë të ndjeshme gjatë tre viteve të fundit. Pas një katërfishimi në vitin 2016 krahasimisht me 2015, është vijuar me një rritje prej 23% në 2017 në krahasim me 2016 dhe paraqiten të qëndrueshme për vitin 2018.

në lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Tarifa per zenien e hapësirave publike	56,894,544	60,465,809	65,713,463	280,234,642	345,627,823	352,796,241



Parashikimi i të ardhurave të kësaj tarife për vitet 2018 - 2020, është si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Tarifa për zënien e hapësirave publike	420,000,000	428,000,000	430,000,000
Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni, kangjella.	400,000,000	408,000,000	410,000,000
Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	20,000,000	20,000,000	20,000,000

N) Tarifa e parkimit.

Tarifa për parkimin e automjeteve në vend parkime publike përfaqëson pagesën e shërbimit që ofron Bashkia Tiranë për vendqëndrime të mjeteve kundrejt biletës, atyre të rezervuara dhe për taksitë e liçensuara.

Me qëllim evidentimin dhe ndjekjen operacionale të parkimit, territori i Bashkisë Tiranë është detajuar në zona tarifore sipas tipologjive, me qëllim vendosjen dhe vjeljen e tarifës së shërbimit të parkimit publik me pagesë – mbështetur në karakteristikat funksionale të tyre.

Krahasuar me vitet e kaluara, arkëtimi i tarifës së parkimit për vitin 2018 ka një rritje të ndjeshme kryesisht nga pagesat e parkimit (të ardhurat) me SMS, si rrjedhojë e riorganizimit të strukturave, mënyrës së arkëtitimit dhe evidentimit në kohë të përdoruesve të parkimit në rrugët me pagesë por dhe në sheshet e miratuara për parkim.

Realizimi në vite dhe pritshmëria për vitin 2018, paraqiten në tabelën si më poshtë:

në lekë

	2013	2014	2015	2016	2017	I pritshmi 2018
Tarifa e parkimit	76,242,781	67,899,565	71,628,038	205,901,190	338,295,014	440,049,889



Parashikimet për arkëtimin e tarifës së parkimit për vitet 2019 - 2020, si më poshtë. Rritja e parashikuar bazohet në zgjerimin e hapësirave të parkimit publik, me dy sheshe të reja si dhe rrugë të tjera që pritet të shtohen në sistemin e tarifimit.

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Tarifa e parkimit të automjeteve	570,000,000	605,000,000	618,000,000
Parkim me kontratë	140,000,000	145,000,000	148,000,000
Parkim me bileta	430,000,000	460,000,000	470,000,000

O) Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime

Tarifa paguhet në masën 1% të vlerës së investimit, për çdo aplikim për leje zhvillimi, infrastrukture dhe ndërtimi sipas përcaktimeve të legjislacionit në fuqi për planifikimin e territorit.

Parashikimi për vitet 2019 – 2021, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	280,000,000	260,000,000	260,000,000

P) Të ardhura të tjera.

Në të ardhurat e tjera përfshihen të ardhurat nga qerata e ndërtesave dhe trojeve, të ardhura nga penalitete administrative apo gjoba të vendosura nga DPTTV apo strukturave të tjera si Policia Bashkiake, Agjencia për Mbrojtjen e Konsumatorëve, etj. Gjithashtu këtu përfshihen edhe të ardhura destinacioni i të cilave nuk identifikohet që në momentin e arkëtimit dhe shpërndahen rast pas rasti pas rakordimeve që realizohen nga DPTTV.

Q) Të ardhura nga pagesat për kopshte, çerdhe e konvikte.

Për fëmijët që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet paguhet tarifa mujore, e cila përbëhet nga tarifa për ushqimin që llogaritet me tarifën ditore dhe ditët e frekuentimit të fëmijës gjatë një muaji.

Parashikimi i të ardhurave për vitet 2019 - 2021, si më poshtë vijon:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Pagesa për kopshtet e fëmijëve	150,000,000	153,000,000	155,000,000
Pagesa për çerdhet e fëmijëve	99,000,000	100,000,000	102,000,000

Struktura e ngarkuar për mbledhjen e tarifave është Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve.

Parashikimi i të ardhurave nga pagesa në Konviktet e Shkollave të Mesme, për vitet 2019 - 2021, paraqitet si më poshtë:

në lekë

Lloji i të ardhurave	Parashikimi 2019	Parashikimi 2020	Parashikimi 2021
Pagesa për Konviktet e Shkollave të Mesme	6,000,000	6,500,000	6,800,000

III.2. Transfertat nga Buxheti i Shtetit

Transferta e Pakushtëzuar


Transfertat e pakushtëzuara, që buxheti qendror i transferon pushtetit vendor, përfshijnë fondet për përballimin e veprimtarive dhe të funksioneve që përcaktohen në aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi. Transfertat e pakushtëzuara shpërndahen ndërmjet njësive të pushtetit vendor sipas formulës së paraqitur në ligjin nr. 68/2017 "Për financat e vetqeverisjes vendore" si dhe udhëzimeve plotësues.

Transferta e pakushtëzuar për Bashkinë e Tiranës në periudhën 2013 – 2019 paraqitet si vijon:

në mijë lekë

	2014	2015	2016	2017	2018	2019
Transferta e pakushtëzuar	1,187,822	1,339,286	1,531,459	1,913,120	2,138,631	2,348,723

Grafikisht:



Transferta e pakushtëzuar nga Buxheti i Shtetit për vitin 2019, është në masën 2,348,723,419 lekë, me një rritje prej 9 %, krahasimisht me vitin e mëparshëm. Transferta përbën 13% të të ardhurave për vitin 2019.

Për vitet 2020-2021, transfertat e pakushtëzuar, referuar parashikimeve të Ministrisë së Financave, do të rritet respektivisht me 2 % dhe 10 % në vit.

Transfertat e pakushtëzuar duhet t'u sigurojë Njësive të Qeverisjes Vendore diferencën mes kostos së ushtrimit të funksioneve (nevojat për shpenzime) dhe të ardhurave që ato krijojnë në mënyrë të pavarur (kapaciteti fiskal).

Në vitin 2019, ashtu sikurse edhe në vitin 2018, transfertat e pakushtëzuar do të përdoret për financimin e shpenzimeve operative dhe kapitale, e ndarë respektivisht në 45% për shpenzimet kapitale dhe 55% për shpenzimet operative.

Transferta Specifike – Transferta e Pakushtëzuar Sektoriale

Funksionet e reja që iu transferuan bashkive në vitin 2016, me Ligjin nr. 139/2015, “Për Vetëqeverisjen Vendore” do të vazhdojnë të financohen edhe në buxhetin e vitit 2019 nëpërmjet Transfertës së pakushtëzuar sektoriale . Më konkretisht:

- Arsimi parashkollor i ndarë me formulë për personelin mësimor dhe stafin mbështetës
- Personeli mbështetës i arsimit para-universitar
- Konviktet e arsimit parauniversitar
- Rrugët rurale
- Shërbimi i mbrojtjes nga zjarri
- Administrimi i Pyjeve
- Ujitja dhe kullimi

Transferta e Kushtëzuar

Fondet e kushtëzuara për financimin e funksioneve të deleguara, nuk miratohen si pjesë përbërëse e buxhetit të njësisë vendore, por reflektohen në dokumentin e realizimit të buxhetit, si fonde të administruara nga njësitë vendore. Sipas akteve ligjore në fuqi, funksione të deleguara në pushtetin vendor janë:

Shërbimi i gjendjes civile si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore, shpenzime operative dhe investime bëhen nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve më të detajuara që bëhen nga Ministria e Brendshme. Numri i punonjësve dhe kuotat përkatëse për këtë funksion përcaktohen nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Qendrat e Rregjistrimit të Bizneseve, si funksion i deleguar i detyrueshëm, parashikimi i shpenzimeve për paga, sigurime shoqërore dhe shpenzime operative bëhet nga bashkitë, në bazë të kuotave dhe udhëzimeve që bëhen nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës.

Përkrahja sociale, si funksion i deleguar i detyrueshëm, Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale detajon në fillim të vitit fondet për përkrahjen sociale për çdo njësi të qeverisjes vendore, në mënyrë specifike për ndihmën ekonomike dhe për pagesën e paaftësisë.

Fondi i Zhvillimit të Rajoneve

Fondi për Zhvillimin e Rajoneve është një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor, për të siguruar zbatimin e objektivave të politikës së kohëzimit territorial, për të patur rajone me zhvillim të balancuar, konkurruese dhe me zhvillim të qëndrueshëm ekonomik, social e mjedisor.

Fondet për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale, të parashikuara si program buxhetor në Fondin Shqiptar të Zhvillimit, janë një mekanizëm financiar konkurrues që mbështet politikën kombëtare të zhvillimit rajonal dhe vendor. Specifikimet, rregullat, kriteret për financimin e projekteve si dhe shpërndarja e Fondit për Infrastrukturën Vendore dhe Rajonale për financimin e projekteve të reja kryhen nga Këshilli Drejtues i Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Subjektet aplikuese dhe zbatuese për fondet e programit Infrastruktura Vendore dhe Rajonale janë njësitë e vetëqeverisjes vendore. Zbatimi i projekteve të miratuara me vendim të Këshillit Drejtues të Fondit Shqiptar të Zhvillimit është përgjegjësi parësore e autoriteteve kontraktuese, të cilët zbatojnë projektet, sipas rregullave dhe akteve ligjore e nënligjore përkatëse.

Për vitet 2016-2018 Bashkisë së Tiranës i janë miratuar projekte nga FZHR në vlerën totale prej 4,764,969,614 lekë, të ndara sipas programeve në vazhdim:

Programi i Menaxhimit të Rrugëve

1. Rikualifikim Urban i bllokut nr.1 (Lapraka), kufizuar me rrugët "Don Bosko"- "Shinat e Trenit" (Filanto)- "Turhan Pashë Përmeti"- "Ibrahim Bashë Bushatliu"- "Lord Bajron"- "Riza Cuka"- "Learton Vathi"- "Pandi Dardha"- "Dritan Hoxha"
2. Rikualifikim urban i rrugëve në bllokun e pallateve "Selitë", të kufizuar nga Rr. "Hamdi Pepa", Rr. "Ilia Dilo Sheperi", Rr. "Visarion Xhuvani" dhe Rr. "Leka i Madh" nj. administrative nr.5
3. Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, Faza e I-re
4. Rikualifikimi Urban i Sheshit Skenderbej, Faza e II-re
5. Rehabilitim i varrezave Sharre dhe lidhja me rrugen ekzistuese Kombinat
6. Itenerare kembesore me piste vrapimi dhe bicikletash ne Parkun e Liqenit Artificial
7. Rikualifikim i Pazarit te Ri (Markata e Mish-Peshkut, restaurim i 4 objekteve dhe rikonstruksion i fasadave perreth sheshit Avni Rustemi dhe pajisjet)
8. Sistem i qenderzuar per menaxhimin e hoteleve dhe taksave te qendrimit ne Bashkine e Tiranës
9. Forcimi i menaxhimit financiar dhe kontrollit ne Bashkine e Tiranës
10. Linearizimi financiar ne institucionet e varesise te Bashkise Tirane
11. Sistemi elektronik i inventarizimit, regjistrimit dhe perdorimit te aseteve te Bashkise Tirane
12. Linearizimi i menaxhimit te aseteve ne institucionet e varesise te Bashkise Tirane
13. Rikualifikimi urban i Bllokut qe kufizohet nga rruga e Elbasanit-Stavri Vinjau-Pjeter Budi dhe Ali Visha NJA2
14. Rikualifikimi urban I Bllokut te Kufizuar nga Rr. "Llambi Bonata", Rr. "Haki Stermilli" "Musine Kokalari" dhe rikonstruksioni i rruges "Zyber Zeneli" NJA6
15. Korsi Bicikletash ne rrugen e Kavajes dhe rrugen e Dibres
16. Ndertim dhe rikonstruksion I rruges qe lidh rrugen "Reshit Petrela" me rrugen: Skender Kosturi"(paralel me rrugen "Jordan Misja")

Programi i Arsimit Parauniversitar & Edukimi

1. Ndertim i salles se koncerteve, prane auditorit te Liceut Artistik "Jordan Misja"
2. Ndertim i shkolles 9 vjecare "Kosova" Tirane
3. Rikonstruksion i Shkolles 9-vjecare "Dora D'istria"

Programi Ujitja dhe Kullimi

1. Blerje eskavator me zinxhir
2. Rehabilitimi i kanalit ujites Vilez, Zall Bastar
3. Rehabilitimi I rrjetit te kanaleve ujites TRU-20, KanaliArbane (rehabilitim i pjesshem)
4. Rehabilitimi I rrjetit te kanaleve ujites TRU-20, KanaliArbane (vazhdim)
5. Rehabilitimi I kanalit te Skoranes
6. Rehabilitimi I pjesshem I skemave ujites dhe sifonave te Mustafa Koë, Rove (Ballcflik), Alltate

Informacion me i detajuar në lidhje me fondet Nga FZHR mund të gjendet në ankesin 1 bashkëlidhur vendimit.

III.3. Burime te tjera financimi / Donacione

I. Donatorë vendas dhe të huaj

Mbështetur në programin e ngritjes së fondeve dhe në procesin e bashkëpunimit dhe marrëdhënieve me donatorët lokalë: vendas dhe të huaj që kanë përfaqësitë e tyre këtu në Shqipëri si UNDP, OSBE, trupat diplomatike/ambasadat, etj, institucione të ndryshme brenda dhe jashtë vendit, bashki binjake në botë, etj si dhe me partneritetin publik-privat në kuadër të përgjegjësisë sociale të bizneseve dhe korporatave; Bashkia Tiranë, në përputhje me prioritetet dhe nevojat për financimin e projekteve dhe nismave të ndryshme të paparashikuara në buxhet, ka gjetur mbështetjen e shumë donatorëve potencialë. Këto donacione janë realizuar nëpërmjet financimit të tyre në forma të ndryshme si: sponsorizime, dhurime, grante, ndihma humanitare, ofrim shërbimesh, konsulenca, marrëveshje bashkëpunimi, etj.

Në periudhën 3 vjeçare Bashkia Tiranë ka arritur të ngrejë fonde donatore në vlerën 1,219,897,490 lekë për projekte specifike dhe ka realizuar 1058 bashkëpunime të frytshme për financimin dhe realizimin e projekteve të ndara sipas fushave të mëposhtme:

<i>në lekë</i>			
Nr.	Emërtimi i bashkëpunimit/ projektit donator	Numri i Kontratave	Vlera e donacioneve
1	Projekti "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht"	210	211,820,072
2	Projekti i gjelbërimit, mbjelljet e reja në Tiranë, mobilim urban, rehabilitim i mjediseve publike, etj	555	334,541,902
3	Projektet e investimit në infrastrukturë, shkolla, rrugë, sinjalistike, etj	114	232,151,895
4	Dhurim automjete, pajisje, kompjutera, etj	73	86,198,720
5	Ndihma humanitare, projekte sociale, kulturore, etj	100	39,372,291
6	Marrëveshje Bashkëpunimi, Programe Financimi, Grante, etj	6	315,812,610
Totali		1058	1,219,897,490

- Projekti "Adopto një çerdhe" dhe "Adopto një kopsht" janë sukseset më të mëdha të këtij procesi. Donatorët e ndryshëm, kompanitë e ndërtimit apo biznese të ndryshme, pa harruar edhe qytetarë të thjeshtë, kanë ofruar si kanë pasur mundësi për të sjellë në një funksion të admirueshëm situatën e këtyre ambienteve të fëmijëve. Ndërhyrjet kanë konsistuar në: heqjen e lagështirës, rikonstruksione të pjesshme, lyerje të mureve të brendshme dhe të jashtme, vendosje kondicionerësh, mobilime të ndryshme në krevatë, dyshekë, tavolina, karrike e shumë e shumë produkte të tjera, kompletimi i tualeteve si dhe kuzhinës me pajisje bashkëkohore dhe për fëmijët e kësaj moshe, etj. Gjithashtu ndërhyrje ka pasur edhe në ambientet e jashtme, sistemime territori, rregullimi i trotuareve, lyerje fasade, mbjellje frutash, perimesh, lule, vendosja e këndeve të lojrave, etj. Në këtë kuadër janë realizuar 210 kontrata me donatorët dhe është përthithur shuma prej 211,820,072 lekësh, duke siguruar ndërhyrjen në pothuaj të gjitha këto godina.
- Një projekt sukcesi tjetër i iniciuar nga Bashkia Tiranë dhe që gjeti mbështetjen e gjerë të të gjithë qytetarëve dhe banorëve në kryeqytet, institucioneve, organizatave vendase dhe të huaja, ambasadave, bizneseve, banorëve të pallateve, nxënësve nëpër shkolla etj është dhurimi i bimësisë dhe drurëve dekorativë për shtimin e gjelbërimit në Tiranë dhe zgjerimin e kurorës së gjelbët të Pyllit Orbital. Për rehabilitimin e lulishteve, mbjellje të ndryshme në parqet dhe rrugët e Tiranës, sipas planifikimit për pyllëzimin e Tiranës dhe rritjen e frymëmarrjes së kryeqytetit, mobilim urban, etj, në bashkëpunim dhe koordinim të nevojave dhe zbatimit të tyre me APR dhe DPN1PQ, si dhe në kuadër të nismave: "Pyllëzimi i Tiranës", "Luaj@Tirana", "Mbill pemën tënde",

“Dhuro një pemë”, “Dhuro një stol” etj, janë realizuar 555 kontrata për projekte me fonde donatore në vlerën 334,541,902 lekë.

- Projektet e investimit në infrastrukturë, në kuadër të mbështetjes së donatorëve kanë konsistuar në ndërhyrjet e realizuara për rikonstruksione të shkollave (hidroizolim tarracës, rehabilitim të lagështirës së klasave, rregullim të suvasë, të tualeteve, vendosje të sistemit ngrohës, paisje me kompjutera, mobilje, mjete mësimore si edhe laboratorët, rehabilitimi i këndeve sportive dhe palestrave, etj), rehabilitimeve në rrugë, vendosjen e sinjalistikave apo kangjellave mbrojtëse, instalimin e ndriçimit të teknologjisë inteligjente LED, risuvatimin e fasadave të pallateve, risistemimin e shtratit të lumenjve apo urave të ndryshme, etj. Donatorët kanë qenë të shumtë, dhe kanë ofruar jo vetëm mbështetjen e tyre financiare por edhe ekspertizën për projekte të ndryshme specifike sipas fushës së tyre që operojnë dhe në mbështetje të nevojave të ndërhyrjeve dhe projekteve të Bashkisë Tiranë. Janë koordinuar 114 kontrata me sponsorizime nga donatorët për projekte dhe është përthithur shuma e financimit në vlerën 232,151,895 lekë.
- Donatorët, në kuadër të përgjegjësisë sociale të bizneseve të tyre, korporatave apo dhe individëve që kanë kontribuar, i janë përgjigjur nismave të Bashkisë Tiranë për të ndihmuar shtresat në nevojë si fëmijët me aftësi të kufizuar apo të moshuarit, ose cdo familje në Tiranë në rastet e emergjencave, si për mbushjen e magazinave të emergjencave të qytetit apo për realizimin e aktiviteteve bamirëse e komunitare dhe të furnizimit të përditshëm me ushqime në mençat sociale të qytetit. Janë finalizuar 100 kontrata për mbështetjen e shtresave në nevojë në territorin e Bashkisë Tiranë në vlerën donatore prej 39,372,291 lekë.
- Gjithashtu është siguruar mbështetje për pajisje të ndryshme në ndihmë të administratës së policisë bashkiake, zjarrfikëseve, institucioneve të varësisë apo drejtorive të aparatit të Bashkisë Tiranë, në kuadër të përmirësimit të kushteve të punës së administratës. Janë finalizuar donacionet me nënshkrimin e 73 kontratave në vlerën 86,198,720 lekë.
- Në kuadër të marrëveshjeve të bashkëpunimit për financimin dhe mbështetjen e nevojave dhe projekteve të ndryshme të Bashkisë Tiranë për investime, ndërhyrje në infrastrukturë, asistencë teknike apo ngritje kapacitetesh, studim fizibiliteti të standardit evropian etj, janë përthitur fonde në formë granti dhe financimi të ndryshme për të cilat janë realizuar 6 marrëveshje që arrijnë fondin prej 315,812,610 lekë.

II. Investime të huaja dhe projekte strategjike

Bashkia Tiranë, në vijim të aplikimeve për financimin me investitorë të huaj dhe për realizimin e projekteve strategjike nëpërmjet thirrjeve dhe programeve e projekteve të bashkëpunimit ndërkufitar e ndërkombëtar, bilateral e multilateral, Komisionin Evropian, organizma financimi me afate zbatimi afatgjata, ka arritur të fitojë disa projekte dhe të lidhë Marrëveshje Bashkëpunimi me potencial financimi të konsiderueshme, si dhe është në pritje të rezultateve të seleksionimit për disa prej tyre.

Nr	PROGRAMI	PROJEKTI
	Projekte ne faze aplikimi	
1	Cooperazione Italiana	Qendra per Emergjencat Civile
2	IT Foreign Affair Ministry	Managment of Cultural and Touristic Services (Exchange and training of youth)
3	IPA THEMATIC	Projekt pilot ne dy zona të Tiranës me uiësiellësin dhe Studim Fizibiliteti
4	ADRION 2018	CAPACITY (PP Partner)
		RIVERGO (PP Partner)
		URANUS (PP Partner)
		CIRCLE (PP Partner)
		Reading Plus (Ass/ Partner)
5	EEA & Norway Grants	Digital Farming Hub to improve employment opportunities for youth, YouthAgro
6	HORIZON 2020	Human Security Europe
	Projekte ne faze implementimi	
1	Ambasada e Katarit	"Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Jeronim De Rada" financim i Ambasadës së Katarit"
2	Ambasada e Katarit	"Rikonstruksioni i shkollës 9-vjeçare Hasan Vogli" financim i Ambasadës së Katarit"
3	AICS Tirana	Përcaktimi i kufijve dhe gjurmës të "Metroboscos-Pyllit Orbital"
4	AZHR2	Projekti "Rikualifikimi i 3 fushave në shkollën e mesme "Sadik Stavileci" dhe 9vjeçare "Katund i Ri". (NJA Kashar)
5	Ambasada Katarit	Projekti "Rikonstruksioni i 2 shesheve me kënde lojërash për fëmijë" financim i Ambasadës së Katarit"
6	Donacion	Rikonstruksioni I fushës sportive "Sabaudin Gabrani 2"
7	Interreg BALKANMED	AIRTHINGS (Fostering resource efficiency and climate change resilience through community based Air Quality Internet of Things) (Shtator 2017- Shtator 2019), mbështetur financiarisht nga "Interreg V-B Balkan-Mediterranean 2014-2020"
8	Interreg BALKANMED	BAS (Stimulating Citizens to Recycle Process Through the Implementation of Benefit Systems – Benefit As you Save), (Shtator 2017- Shtator 2019),
9	"Adriatic-Ionian Programme INTERREG V-B Transnational 2014-2020"	Projektit SMILE (FirSt and last Mile Inter-modal mobility in congested urban arEas of Adrion Region) , (Janar 2018- Tetor 2019),

III.4 PARASHIKIMI I SHPENZIMEVE PËR PERIUdhËN 2019 -2021

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për periudhën 2019-2021, për të gjitha funksionet parashikohen respektivisht në masën 18,335,187,020 lekë, 17,236,123,354 lekë dhe 16,406,713,933 lekë.

Në parashikimet e tre viteve buxhetore është përfshirë edhe fondi që planifikohet të mbartet nga vitet paraardhëse . Fondet e mbartura përbëjnë fondet e papërdorura në vitin respektiv të arkëtimit të tyre, ku përfshihen të ardhurat nga dy burime financimi, të ardhurat e veta dhe transferata e pakushtëzuar.

Shpenzimet e përgjithshme të Bashkisë së Tiranës për vitet 2019-2021, parashikohen të ndara sipas programeve buxhetore si më poshtë:

në lekë

Programi	Plan 2018	Plan 2019	% ne strukturë	Plan 2020	Plan 2021
1 Shërbimet Publike Vendore	4,801,088,106	5,197,521,654	28%	5,240,614,780	5,502,927,891
2 Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit		20,429,976	0%		0
3 Menaxhimi i Rrugeve dhe Transportit Rrugor	3,470,766,902	3,748,879,335	20%	3,824,127,600	3,016,501,968
4 Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	2,482,213,319	3,896,587,296	21%	2,614,324,589	2,626,967,621
5 Kujdesi Social	365,915,365	348,994,009	2%	244,865,407	251,193,492
6 Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	1,247,579,109	847,363,319	5%	1,263,923,289	794,078,225
7 Zhvillimi Ekonomik vendor, zhvillimi rural, bujqësor dhe pyje	198,526,388	209,597,195	1%	215,577,211	124,362,464
8 Kultura dhe Turizmi	216,916,599	267,257,664	1%	234,593,335	249,004,917
9 Zhvillimi i Rinisë dhe Sportit	213,812,244	247,239,193	1%	139,804,884	138,429,638
10 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,747,013,709	2,778,295,743	15%	2,832,801,585	2,910,231,471
11 Siguria Publike	572,049,258	744,343,770	4%	625,490,674	793,016,247
12 Admsitrimi I Pyejeve	0	9,050,054	0%	0	0
13 Rruget Rurale	0	19,627,811	0%	0	0
TOTALI	16,315,881,000	18,335,187,020	100%	17,236,123,354	16,406,713,933


II. 1 Shpenzimet sipas klasifikimit ekonomik

Shpërndarja sipas klasifikimit ekonomik është bërë si më poshtë, ku peshën më të madhe e zënë shpenzimet operative dhe ato te personelit me 61%.

në lekë

Shpenzime sipas klasifikimit	Plan 2018	Plan 2019	%	Plan 2020	Plan 2021
Shpenzime personeli	4,178,355,749	5,565,643,353	31%	4,584,270,528	4,841,400,489
Shpenzime tjera operative	5,173,269,638	5,745,316,261	31%	5,543,349,424	5,624,811,700
Shpenzime kapitale	6,964,255,613	7,024,227,406	38%	7,108,503,401	5,940,501,744
TOTAL	16,315,881,000	18,335,187,020	100%	17,236,123,354	16,406,713,933

Paraqitje grafike e realizimit të shpenzimeve të vitit 2019:



Raporti mes shpenzimeve korente dhe atyre kapitale është respektivisht 62% me 38% për vitin 2018.

II.4.1 Shpenzimet kapitale

Për vitin 2019 fondi total për shpenzime kapitale është në shumën 7,024,227,406 lekë ose 38% ndaj totalit të shpenzimeve. Për vitet 2020 dhe 2021, buxheti i investimeve parashikohet respektivisht 7,108,503,401 lekë dhe 5,940,501,744 lekë.

Tabela më poshtë paraqet fondin e shpenzimeve kapitale për vitet 2019-2021, sipas programeve buxhetore:

Në lekë

Programi	Plan 2018	Plan 2019	% ne strukturë	Plan 2020	Plan 2021
1 Shërbimet Publike Vendore	1,879,383,420	2,016,784,071	29%	2,046,526,975	2,256,781,197
2 Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit		0	0%		
3 Menaxhimi i Rrugeve dhe Transportit Rrugor	2,506,405,324	2,664,380,412	38%	2,676,001,920	1,809,313,773
4 Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	938,003,887	1,160,149,532	17%	924,767,566	911,212,850
5 Kujdesi Social	90,535,083	24,247,622	0%	11,263,200	11,114,800
6 Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	1,158,579,109	793,363,319	11%	1,223,823,289	794,078,225
7 Zhvillimi Ekonomik vendor, zhvillimi rural, bujqësor dhe pyje	3,000,000	14,299,900	0%	15,792,300	13,274,800
8 Kultura dhe Turizmi	29,986,950	29,942,071	0%	12,627,730	4,800,000
9 Zhvillimi i Rinisë dhe Sportit	113,397,001	123,713,298	2%	15,128,471	10,098,100
10 Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	228,083,420	176,373,443	3%	182,571,951	129,828,000
11 Siguria Publike	16,881,420	20,973,738	0%	0	0
12 Admnsitrimi I Pyejeve	0	0	0%	0	0
13 Rruget Rrurale	0	0	0%	0	0
TOTALI	6,964,255,614	7,024,227,406	100%	7,108,503,402	5,940,501,745

II.4.2. Shpenzime për Personelin

Kërkesat gjithnjë e në rritje, problematikat por edhe sfidat që ndeshen për mirëmenaxhimin e territorit të qytetit të Tiranës si dhe zgjerimin e funksioneve të reja të transferuara së fundmi, kërkojnë rritjen e numrit të personelit në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe disa prej njësive organizative në varësi të këtij institucioni. Ky miratim është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

- Rritjen e efikasitetit dhe e performancës së strukturave organizative.
- Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve procedurale.
- Përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.
- Koordinimin e administrimit territorial.
- Realizimin e plotë të objektivave.
- Maksimizimin e luftës kundër evazionit fiskal.

Në Aparatin e Bashkisë së Tiranës dhe tek Njësitë Administrative do të shtohen në total 31 (tridhjetë e një) punonjës. Efektet financiare pas miratimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për BT janë 24,292,601 Lekë.

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 e Punëtorëve të Qytetit

Miratimi i punonjësve me kontratë të caktuar për Drejtorinë e Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit sollti një përmirësim në menaxhimin e proceseve të punës në Drejtorinë e Pastrimit të Qytetit, Drejtorinë e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit, dhe Sektori Flota e Transportit. Me shumë vështirësi është bërë e mundur mbajtja nën kontroll e pastërtisë së rrugëve dytësore, blloqet e banimit në 24 njësi administrative të bashkisë së Tiranës.

Drejtoria e Pastrimit të Qytetit, sipas grafikut të miratuar nga Drejtoria e Përgjithshme Nr. 1 të Punëtorëve të Qytetit kryen shërbime në:

Sip. totale për Njësitë Administrative 4.397.072 m²

Sip. totale për 13 ish Komunat 1.590.000 m²

Sip. totale për Lulishtet 154.999 m²

Sip. totale për Autostradën 105.000 m²

Sip. totale për Tregjet 284.412 m²

Sip. totale për Lumin Lana 104.039 m²

Norma ditore për një punëtor në firma private është 6.000 m², ndërsa norma ditore për një punëtor në Drejtorinë e Pastrimit të Qytetit është aktualisht 41.472 m².

Drejtoria e Zhvillimit dhe e Mirëmbajtjes së Gjelbërimit të Qytetit ka në inventarin e saj lulishte, sheshe, gjelbërim rrugor, kosha, stola dhe basene ujore. Shtimi i sipërfaqeve të gjelbërta kërkon shtim të numrit të fuqisë punëtore.

Duke menduar të mbahet i njëjti rritëm pune dhe cilësisë së shërbimit propozohet të shtohen në total 9 (nëntë) punonjës, për shkak të fluksit të lartë të punëve që përballon kjo drejtori.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për D.P.Nr. 1 P.Q, do të jenë 6,762,784 Lekë.

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 2 e Punëtorëve të Qytetit

Fokusi dhe objektivi kryesor i punës së Drejtorisë së Përgjithshme Nr. 2 të Punëtorëve të Qytetit qëndron në:

mirëmbajtjen me efikasitet të rrugëve rurale, sipas inventarit të tyre dhe administrimin e ujërave në të gjitha njësitë administrative; mirëmbajtjen e rrjetit të ndriçimit publik dhe vënien në efikasitet 100% të rrjetit semaforëve dhe sinjalistikës rrugore, në të gjitha njësitë administrative; përballimin e të gjithë situatave të përditshme dhe emergjente, që realizohen me mjetet aktuale dhe shtesë të transportit, të disponueshme në parkun e makinerive të drejtorisë, për mirëmbajtje, ndriçim-sinjalistikë, kullim, rrugë rurale.

Për mbarëvajtjen e kërkesave dhe funksioneve të shtuara në të gjitha drejtoritë, për burime njerëzore, për përpunimin e të dhënave dhe treguesve statistikore për personel të kualifikuar në sektorin e prodhimit si

rezultat i volumeve të shtuara të punës u evidentua domosdoshmëria e riorganizimit të punës dhe propozohet shtimi i strukturës me 14 punonjës, konkretisht për:

mirëmbajtje të rrjetit të ndriçimit publik;
përballimi i emergjencave;
përballimi i kerkesave dhe funksioneve në të gjitha drejtoritë për "IT".

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për D.P.Nr.2P.Q., do të jenë 9,496,616 Lekë.

Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve të Qytetit

Objektivat që Drejtoria e Përgjithshme Nr. 3 e Punëtorëve kërkon të realizojë për t'iu përgjigjur më mirë sfidës që ka sjellë reforma administrative territoriale, përmes zgjerimit të territorit dhe shtimit të numrit të objekteve shkolla, kopshte, çerdhe, ndaj të cilave kërkohet shërbim mirëmbajtje, sjell të nevojshëm kërkesën për shtimim numrit të punonjësve. Për vitin 2019 është i nevojshëm shtimi prej 13 (trembëdhjetë) punonjësish kryesisht në nivel Specialistë dhe punëtorë.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për D.P.Nr.3 P.Q., do të jenë 8,468,568 Lekë.

Qendra Kulturore "Tirana"

QKT gjatë vitit 2018 ka shtuar në mënyre të ndjeshme numrin e shfaqjeve për fëmijë të grupmoshave të ndryshme duke bërë të mundur afrimin e artit tek fëmijët, e sidomos shtimin e dëshires së tyre për t'u aktivizuar në performanca të ndryshme artistike. Aktualisht shtimi i numrit të shfaqjeve ka sjellë si pasojë mospërballimin e punës me punonjësit aktualë të Qendrës Kulturore "Tirana", ndaj për të ruajtur e rritur cilesinë e numrin e shfaqjeve për vitin 2019 kërkohet shtim i numrit të punonjësve me kohë të plotë të kësaj qëndre, në total 10 (dhjetë) punonjës.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për QKT do të jenë 7,070,770 Lekë.

Drejtoria e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore

Bazuar në eksperiencën e vitit 2018, performancën dhe administrimin e taksave dhe tarifave vendore nga DPTTV-Tiranë për efekt të përmirësimit të rezultateve të mëtejshme të punës është i nevojshëm shtimi i numrit të punonjësve. Konkretisht propozohen 20 punonjës shtesë për administratën e DPTTV. Gjithashtu, për efekt të përmirësimit dhe digitalizimit të arkivës së DPTTV, mirëorganizimi i së cilës është shumë i rëndësishëm për mbarëvajtjen e punës së institucionit është propozuar një shtesë prej 10 punonjës me kontratë të përkohshme një vjeçare. Në total numri i punonjësve që shtohen është 30.

Ky shtim i numrit të punonjësve është i nevojshëm duke marrë në konsideratë faktorët e mëposhtëm:

Rritjen e efikasitetit dhe performancës së strukturës organizative.

Përmirësimin e procedurave dhe respektimin e afateve procedurale.

Përmirësimin e shërbimit ndaj taksapaguesve dhe rritjen e besueshmërisë ndaj institucionit.

Kordinimin më të mirë të administrimit territorial.

Realizimin e plotë të objektivave.

Maksimizimin e luftës kundër evazionit fiskal.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për Drejtorinë e Përgjithshme e Taksave dhe Tarifave Vendore do të jenë 20,328,768 Lekë.

Qendra Ekonomike e Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve

Nevojat emergjente pas shtimit të kapaciteteve në kopshtet dhe çerdhet e qytetit të Tiranës, si dhe njëkohësisht ruajtjen e cilësisë së shërbimit në to, propozohet shtimi prej 190 (njëqind e nëntëdhjetë) punonjësish (ku 160 punonjës shpenzimet e të cilëve do të mbulohen nga transferata specifike akorduar me ligjin për Buxhetin e Shtetit) dhe 30 punonjës si shtesë në strukturën organizative të QEZHEF-së me synimin rregullimin e situatës në të gjitha kopshtet dhe çerdhet e Tiranës, kryesisht me focus më të madh tek përmirësimi i cilësisë së shërbimit tashmë edhe në kopshte siç janë punuar këto vite me përmirësimin e çerdheve. Rritja e madhe e frekuentimit të çerdheve dhe të kopshteve ka sjellë nevojën e shtimit të edukatoreve dhe ndihmës edukatoreve që do të rregullojnë aktualisht pjesën e shërbimit.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës prej 30 punonjësve për vitin 2019, për Qendrën Ekonomike të Zhvillimit dhe Edukimit të Fëmijëve do të jenë 19,067,956 Lekë.

Agjensia e Parqeve dhe Rekreacionit

Zhvillimi, administrimi dhe mirëmbajtja e parqeve, mbrojtja e kurorave të gjelbra brenda territorit të Bashkisë së Tiranës janë disa nga detyrat funksionale të APR-së. Këtu përmendim mirëmbajtja e pjesës jugore të PMLAT (bimësi, korsi vrapimi dhe bicikletash, pedonale), realizuar sipas projektit të Bashkisë, mirëmbajtja e parqeve të reja Farkë, Kashar, Vaqarr dhe pyllit orbital me proceset e punës (kositje e barit, prerje ferrash, krasitje të drurëve dekorativë, ujitja e sipërfaqeve të gjelbëra dhe bimësisë dekorative, evadimi i mbeturinave të grumbulluara, kryerja e shërbimeve fitosanitare spërkatja me pesticide dhe herbicide, plehërim kimik). Gjithashtu shtimi i disa aktiviteteve apo rritja e volumit të punës të proceseve si:

Mirëmbajtja e Shesheve rekreative “Luaj Tirana”

Shtimi i aktiviteteve rekreative

Mbjedhje dhe shtimi i bimësisë

Kerkesës në rritje për trajtimin e bimësisë dekorative,

Mirëmbajtjen e infrastrukturës

Ndaj për të ruajtur e rritur cilësinë e shërbimit për vitin 2019 kërkohet shtim i numrit të punonjësve të kësaj agjensie në total 14 (katërmëdhjetë) punonjës.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për Agjensinë e Parqeve dhe Rekreacionit do të jenë 8,922,168 Lekë.

Qendra Sociale “Multidisiplinare”

Lidhur me riorganizimin e strukturës organizative të Qendrës Sociale Multidisiplinare, në funksion të cilësisë së shërbimit dhe mbulimit si duhet me profesionistë të procesit të identifikimit, vlerësimit dhe ofrimit të shërbimeve, propozohet një shtesë në stafin profesionist të qendrës, për vitin 2018 konkretisht me 2 (dy) punonjës të shërbimeve sociale multidisiplinare. Kryesisht këta punonjës do të transferohen nga projekti “Save the Children” që më parë ishte i mbuluar prej tyre për qendrën, por pas përfundimit të kontratës, Bashkia duhet të vazhdojë ofrimin e shërbimit me fondet e veta.

Efektet financiare të aplikimit të shtesës në numrin e punonjësve për vitin 2019, për Qendrën Sociale Multidisiplinare do të jenë 1,549,484 Lekë.

Klubet sportive

Me VKM nr 441 datë 18.07.2018 është miratuar ndryshimi i varësisë së Klubit Sportiv Shumësportësh “Partizani” dhe Klubit Sportiv “ Studenti” nga Ministria e Arsimit, Sportit dhe Rinisë tek Bashkia Tiranë. Ky numër në total 26 persona transferohet pranë Bashkisë. Duke qënë se ligji i buxhetit 2019 ende nuk është miratuar deri në njoftimin mbi fondet që do të shoqërojnë këtë transferim, në këtë moment sugjerojmë përfshirjen e shtesës së numrit të punonjësve sipas referencave të cituara më lart.

II.4.3. Shpenzime Operative dhe të tjera

Shpenzimet operative dhe të tjera janë parashikuar në shumën 5,745,316,261 lekë për vitin 2019, 5,543,349,424 lekë për vitin 2020 dhe 5,624,811,700 lekë për vitin 2021. Këto shpenzime përbëjnë 31% të totalit të buxhetit për vitin 2019 dhe përbëhen nga:

- Shpenzimet operative të aparatit të Bashkisë dhe institucioneve në varësi;
- Përdorimi i Fondit Rezervë dhe Fondit të Kontigjencës;
- Transferta të tjera për individët

Për periudhën afatmesme 2019-2021, Fondi rezervë dhe ai i Kontigjencës, është llogaritur sipas ligjit për menaxhimin e sistemit buxhetor. Këto fonde do të përdoren sipas përcaktimeve ligjore:

Fondi Rezervë do të përdoret për financimin e shpenzimeve që nuk mund të parashikohen gjatë hartimit të buxhetit, me vendime të Këshillit Bashkiak;

Fondi i Kontigjencës do të përdoret për të përballuar efektet e mosrealizimit të të ardhurave, nevojën e kryerjes së financimeve të reja dhe shtimin e financimeve mbi fondet e miratuara të programeve egzistuese, në rast se do të jetë e nevojshme gjithmonë me miratimin e Këshillit Bashkiak.

Transfertat për individët përbëhen nga transfertat në mbështetje sociale të shtresave në nevojë si bonusi i qerasë, stimuj ekselence, si ai për nxënësit e shkëlqyer dhe stimuj të tjerë si pagesa për bebet, të cilat do të vazhdojnë të paguhen edhe gjatë vitit 2019.

Në thelb të planifikimit të shpenzimeve operative është racionalizimi i shpenzimeve administrative, duke vënë theksin në rritjen e financimit për shërbimet publike me qëllimin e përdorimit të tyre për përmbushjen e funksioneve kryesore të Bashkisë së Tiranës.

Peshën më të madhe në shpenzimet operative e mbajnë funksionet prioritare të Bashkisë së Tiranës: shërbimet publike vendore, arsimit parauniversitar dhe mirëmbajtja e rrugëve, pasuar nga kujdesi social dhe zhvillimi ekonomik vendor, shpenzime të cilat financojnë ofrimin e shërbimeve ndaj qytetaëve, duke mbajtur fokusin në uljen e shpenzimeve administrative.

Shpenzimet operative dhe të tjera për vitet 2019-2021 parashikohen sipas programeve buxhetore si më poshtë:

në lekë

	Programi	Plan 2018	Plan 2019	Plan 2020	Plan 2021
1	Shërbimet Publike Vendore	2,921,704,687	3,180,737,583	3,194,087,805	3,246,146,694
2	Infrastruktura e Ujitjes dhe Kullimit	0	20,429,976	0	0
3	Menaxhimi i Rrugeve dhe Transportit Rrugor	964,361,578	1,084,498,923	1,148,125,681	1,207,188,194
4	Arsimi Parauniversitar dhe Edukimi	1,544,209,433	2,736,437,764	1,689,557,023	1,715,754,768
5	Kujdesi Social	275,380,280	324,746,387	233,502,207	240,078,692
6	Strehimi dhe Planifikimi i Territorit	89,000,000	54,000,000	40,000,000	0
7	Zhvillimi Ekonomik vendor, zhvillimi rural, bujqësor dhe pyje	195,526,388	195,297,295	199,984,911	111,087,664
8	Kultura dhe Turizmi	186,929,649	237,315,593	221,965,605	244,204,917
9	Zhvillimi i Rinisë dhe Sportit	100,415,243	123,525,895	124,676,413	128,331,542
10	Planifikimi, Menaxhimi dhe Administrimi	2,518,930,290	2,601,922,300	2,650,229,634	2,780,403,471
11	Siguria Publike	555,167,838	723,370,032	625,490,674	793,016,247
12	Administrimi I Pyejeve	0	9,050,054	0	0
13	Rruget Rrurale	0	19,627,811	0	0
	TOTALI	9,351,625,386	11,310,959,614	10,127,619,952	10,466,212,189

Bilanci përmbledhës i të ardhurave dhe shpenzimeve të parashikuara për periudhën 2019 – 2021 paraqitet në tabelën si më poshtë:

E m ë r t i m i	PARASHIKIMI	PARASHIKIMI	PARASHIKIMI	PARASHIKIMI
	2018	2019	2020	2021
I Të ardhura të taksueshme	8,782,500,000	8,972,750,000	8,905,255,000	8,874,260,000
1 Taksa mbi pasurinë e paluajtshme	2,510,000,000	2,410,000,000	2,808,000,000	2,840,000,000
a Familjarët	510,000,000	510,000,000	870,000,000	900,000,000
b Subjektet Tregtare	2,000,000,000	1,900,000,000	1,938,000,000	1,940,000,000
2 Taksa e ndikimit ne infrastrukture nga ndertimet e reja	3,200,000,000	4,000,000,000	3,500,000,000	3,400,000,000
3 Taksa e përkohëshme per infrastrukturen Arsimore	892,000,000	860,000,000	876,000,000	892,000,000
a Familjarët	342,000,000	310,000,000	316,000,000	322,000,000
b Subjektet Tregtare	550,000,000	550,000,000	560,000,000	570,000,000
4 Taksa e tabelës	510,500,000	400,250,000	408,255,000	416,260,000
a Tabelë identifikuese/sinjalizuese	500,000	250,000	255,000	260,000
b Tabelë reklamuese	510,000,000	400,000,000	408,000,000	416,000,000
5 Taksa e fjetjes në hotel	80,000,000	85,000,000	86,000,000	87,000,000
6 Taksa mbi truallin	60,000,000	60,000,000	61,000,000	62,000,000
7 Taksa mbi token Bujqesore	50,000,000	50,000,000	51,000,000	52,000,000
8 Taksa mbi kalimin të drejtës pronësisë për pasuritë e paluajtshme	680,000,000	300,000,000	300,000,000	300,000,000
9 Taksa vjetore e mjeteve te perdorura	380,000,000	380,000,000	385,000,000	390,000,000
10 Taksa mbi te ardhurat personale	250,000,000	257,500,000	260,000,000	265,000,000
11 Tatimi Thjeshtuar mbi Fitimin e BV	170,000,000	170,000,000	170,000,000	170,000,000
II Të ardhura jo tatimore	4,194,750,000	4,386,280,000	4,454,880,000	4,494,280,000
1 Tarifat	3,334,500,000	3,352,800,000	3,416,900,000	3,452,000,000
a Tarifa e pastrimit	2,166,000,000	2,070,000,000	2,110,000,000	2,129,000,000
a.1 Familjarët	836,000,000	730,000,000	744,000,000	759,000,000
a.2 Subjektet Tregtare	1,330,000,000	1,340,000,000	1,366,000,000	1,370,000,000
b Tarifa për zënien e hapësirave publike	490,000,000	420,000,000	428,000,000	430,000,000
b.1 Tarifa për zënien e hapësirave publike me platforma betoni,kangjella. Tarifa për zënien e hapësirave në tregjet publike	440,000,000	400,000,000	408,000,000	410,000,000
b.2	50,000,000	20,000,000	20,000,000	20,000,000
c Tarifa e parkimit te automjeteve	450,000,000	570,000,000	605,000,000	618,000,000
c.1 Parkim me kontratë	126,000,000	140,000,000	145,000,000	148,000,000
c.2 Parkim me bileta	324,000,000	430,000,000	460,000,000	470,000,000
d Tarifa për shqyrtimin e kërkesës për leje për punime	220,500,000	280,000,000	260,000,000	260,000,000
e Tarifa sherbimi te MZSH	5,000,000	8,000,000	9,000,000	10,000,000
f Tarifa e sherbimit veterinar	3,000,000	4,800,000	4,900,000	5,000,000
2 Të ardhura të tjera	704,250,000	778,480,000	778,480,000	778,480,000
a Te ardhura nga qerate	65,500,000	63,000,000	63,000,000	63,000,000
b Te ardhura te institucioneve te varesise	138,750,000	165,480,000	165,480,000	165,480,000
c Te ardhura te tjera (penalitetet administrative; te padetajuara; etj.)	500,000,000	550,000,000	550,000,000	550,000,000
3 Pagesa	156,000,000	255,000,000	259,500,000	263,800,000
a Per kopshtet e femijeve	94,240,000	150,000,000	153,000,000	155,000,000
b Per çerdhet e femijeve	57,760,000	99,000,000	100,000,000	102,000,000
c Per Konviktet e Shkollave te Mesme	4,000,000	6,000,000	6,500,000	6,800,000
Shuma	12,977,250,000	13,359,030,000	13,360,135,000	13,368,540,000
Transferta e pakushtezuar	2,631,705,291	2,348,723,419	2,375,988,354	2,638,173,933
Transferta e pakushtezuar sektoriale		1,127,433,601		
Te mbartura	3,169,347,035	1,500,000,000	1,500,000,000	400,000,000
Totali i të ardhurave	18,778,302,326	18,335,187,020	17,236,123,354	16,406,713,933
I. Shpenzime Korrente	10,524,679,712	11,170,959,614	9,987,219,952	10,291,212,189
1 Personeli (Paga dhe Sigurime Shoqerore)	4,091,957,260	5,565,643,353	4,584,270,528	4,841,400,489
2 Shpenzime per interesa	88,000,000	150,000,000	150,000,000	150,000,000
3 Shpenzime Operative Mirëmbajtje	5,989,446,024	5,196,022,261	5,060,347,424	5,111,905,700
4 Transferta Individe	309,027,550	233,694,000	169,142,000	163,507,600
5 Transferta të brendshme	46,248,878	25,600,000	23,460,000	24,398,400
6 Transferta jashtë				
II. Fondi Rezervë, Kontigjenca	133,550,000	140,000,000	140,400,000	175,000,000
1 Fondi Rezervë	113,550,000	100,000,000	100,000,000	125,000,000
2 Fond Kontigjenca	20,000,000	40,000,000	40,400,000	50,000,000
III Shpenzime Kapitale	8,120,072,614	7,024,227,406	7,108,503,401	5,940,501,744
Financim i Brendshëm	0	0	0	0
Totali i të Shpenzimeve	18,778,302,326	18,335,187,020	17,236,123,354	16,406,713,933